



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD



RESPUBLICA

E DREJTA E INFORMIMIT 2024

10 vjet me ligjin “e gjashtë në botë”



E DREJTA E INFORMIMIT 2024

10 vjet me ligjin “e gjashtë në botë”

Ky publikim është përgatitur me mbështetjen e National Endowment for Democracy.
Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të interpretohet se reflekton opinionin e National Endowment for Democracy.

Autorë:

Av. Dorian Matlija

Dr. Irena Dule

Av. Brunilda Qershori

Botues: Qendra “Res Publica”

Redaktor: Dorian Matlija

Faqosja dhe kopertina: Jona Xhufi

© Res Publica 2025

PËRMBAJTJA

7 Hyrje

8 Metodologjia

9 Zhvillimet ligjore gjatë viteve 2014-2024

9 Çfarë solli si risi ligji 119/2014

11 Amendamenti nr. 78/2023

12 Ratifikimi i Konventës së Tromsos nga Shqipëria

13 Gjyqtarët e medias

14 Agjencia për Media dhe Informim

15 Vlerësimi i transparencës proaktive

15 Të dhënat e hapura dhe ripërdorimi i informacionit në sektorin publik

16 Platforma "Transparent Albania"

16 Sa vlerë ka etiketa "ligji i gjashtë në botë"?

19 Transparenca e autoriteteve publike

19 Vlerësimi i transparencës proaktive

26 Sjellja e institucioneve ndaj kërkesave për informacion

33 Komisioneri për të Drejtën e Informimit

34 Rezoluta e Kuvendit e vitit 2023

35 Numri i ankesave drejtuar Komisionerit

36 Subjektet që i janë drejtuar Komisionerit

37	Numri i vendimeve të marra nga Komisioneri
39	Kohëzgjatja e marrjes së vendimeve nga Komisioneri
40	Aplikimi i sanksioneve

42 Të dhëna nga platforma “Publeaks.al”

43	Përdorimi i faqes Publeaks.al
43	Aplikantët sipas grupmoshave
44	Aplikantët sipas arsimimit
45	Aplikantët sipas gjinisë

47 Raste praktike të vitit 2024

52 Konkluzione

52	Reagimi ndaj kërkesave për informacion
53	Programet e transparencës
53	Struktura për zbatimin e ligjit
53	Veprimtaria e Komisionerit
53	Çështje të veçanta dhe institucione të tjera
54	Zhvillime ndërkombetare

55 Rekomandime

I. HYRJJE

Ky raport është hartuar nga Qendra Res Publica, me mbështetjen bujare të National Endowment for Democracy (NED), si pjesë e projektit “Promovimi i lirisë së shprehjes dhe të drejtës së informimit në Shqipëri”. Viti 2024 shënon një pikë emblematike. Plot dhjetë vjet nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Me këtë rast, raporti synon të masë sa efektiv ka qenë ky ligj në konkretizimin e koncepteve të reja që solli, pasi një dekadë është kohë e mjaftueshme për të dalluar qartë pikat e forta dhe të dobëta, duke u mbështetur te praktika.

Që prej miratimit të ligjit, Res Publica ka mbajtur një sy vigjilent mbi zbatimin e tij, duke testuar në mënyrë të vazhdueshme transparencën proaktive, publikimin dhe përditësimin e programeve të transparencës, si edhe transparencën reaktive, pra mënyrën se si institucionet iu përgjigjen kërkesave konkrete për informacion.

Për të matur pulsin e administratës publike gjatë këtij viti jubilar, ekipi monitoroi si zakonisht një kampion prej 100 institucioneve dhe depozitoi mbi 200 kërkesa për informacion me tematika që varionin nga mjedisi të prokurimit publike. Krahas kësaj pune në terren, raporti ndjek edhe institucionin kujdestar, Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për të kuptuar sa efektivisht ndërhyr ai përballë vonësive apo refuzimeve të pajustificuara.

Dokumenti nuk kufizohet vetëm në shifra, por ai rikthen në vëmendje rrugëtimin e një ligji të vlerësuar si një nga më progresivët në botë, dhe që në praktikë has pengesa, si: programet e transparencës të papërditësuara, vonesa përtej afateve ligjore, mungesë ose mospërgatitje koordinatorësh dhe, jo rrallëherë, moszbatim vendimesh të Komisionerit. Për ta bërë panoramën më të prekshme, raporti sjell raste konkrete nga praktika administrative e gjyqësore që ilustrojnë mënyrën si qytetarë, gazetarë e organizata të shoqërisë civile kanë përdorur ligjin për të nxjerrë në dritë dokumente publike.

Kësisoj, Res Publica synon jo vetëm të bëjë bilancin e një dekade, por edhe të ofrojë të dhëna e reflektive që mund të orientojnë përmirësime ligjore, institucionale e kulturore. Raporti është menduar si një mjet i dobishëm për gazetarët që hulumtojnë, për qytetarët që kërkojnë llogari, për juristët që mbrojnë të drejtën e informimit dhe për vendimmarrësit që promovojnë një administratë më transparente e të përgjegjshme.

II. METODOLOGJIA

Monitorimi i zbatimit të ligjit "Për të drejtën e informimit", është bërë me baza krahasuese, duke krahasuar zbatimin e tij gjatë vitit 2024 me vitet e tjera paraardhëse, duke përdorur të njëjtën metodologji që nga viti 2015.

Ligji "Për të drejtën e informimit" i ndryshuar, i jep rëndësi transparencës proaktive të institucionit duke i detyruar ato jo vetëm në publikimin e programeve të transparencës, por edhe me përditësimin e tyre. Për realizimin e këtij raporti janë monitoruar 100 institucione, të cilat përfshijnë 20 autoritetet publike më të rëndësishme nga 5 kategori: pushteti qendror, pushteti vendor, drejtësia, organet e pavarura dhe institucionet e varësisë së pushtetit ekzekutiv.

Për realizimin e një kuadri monitorimi më të plotë, duke ruajtur të njëjtën metodologji me vitet e kaluara, ResPublica këtë vit ka dërguar 200 kërkesa për informacion, duke testuar në këtë mënyrë sjelljen e institucionit. Kërkesat për informim kanë pasur objekte të ndryshme, duke përfshirë fusha të ndryshme si: mjedisi, ekonomia, kultura, rindërtimi, prokurimet publike, etj. Kërkesat i janë drejtuar institucioneve të ndryshme, duke përfshirë, organe të pushtetit qendror; të pushtetit vendor; të drejtësisë, organe të pavarura si dhe institucione varësie.

Për të vlerësuar sjelljen e tyre janë marrë në konsideratë elementët si: koha e kthimit të përgjigjes, ankime pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, reagimi i institucioneve pas ankimit etj. Të gjitha gjetjet pasqyrohen në një tablo duke bërë edhe krahasimin e zbatimit të ligjit "Për të drejtën e informimit" ndër vite.

Për vitin 2024, njëlloj si në vitet paraardhës, është monitoruar veprimtaria e Komisionerit, si institucioni kyç që ka për detyrë të kujdeset për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit. Monitorimi konsiston në analizimin e të dhënave sa i takon numrit të ankesave të adresuara pranë këtij institucioni, cilët kanë qenë ankuesit, si ka disponuar Komisioneri në lidhje me ankesat, llojet e vendimeve të marra, aplikimin e sanksioneve me gjobë dhe afatin brenda të cilit janë marrë vendimet. Të gjitha këto të dhëna janë krahasuar me të dhënat e viteve të kaluara, duke dhënë kështu një panoramë më të gjerë të veprimtarisë së Komisionerit.

Një nga elementët e trajtuar në këtë raport është dhe "të dhënat e hapura/open data" dhe detyrimi i autoriteteve publike për publikimin e tyre.

III. ZHVILLIMET LIGJORE GJATË VITEVE 2014 -2024

3.1 Çfarë solli si risi ligji 119/2014

Pas 15 vitesh eksperiencë me ligjin e parë, nr. 8503/1999, Shqipëria vendosi t'i japë së drejtës për informim një frymë të re me ligjin nr. 119/2014. Kjo reformë nuk ishte thjesht një riparim rregullash, por ndryshoi logjikën e transparencës publike.

Ligji i ri, i cili u përgatit me shtysën e shoqërisë civile gjatë vitit 2012, e zgjeroi shtrirjen e vet përtej administratës qendrore dhe njësite vendore, duke përfshirë edhe shoqëritë ku shteti mban shumicën e aksioneve, si dhe çdo person privat që ushtron funksione publike. Kjo nënkupton se sot, një aeroport koncesionar apo një ndërmarrje shtetërore energjetike nuk mund të fshihet pas statusit “privat”.

Parimi “kërko dhe do të marrësh” u zëvendësua me parimin “publiko para se të ta kërkojnë”. Çdo institucion duhet të hartojë e të përditësojë programin e transparencës dhe regjistrin online të kërkesave e përgjigjeve, duke e bërë informacionin bazë të aksesueshëm pa formalitete.

Në aspektin procedural, afati 40 ditor i ligjit të vjetër për t'iu përgjigjur qytetarit u shkurtua në 10 ditë pune, me mundësi shtyrjeje vetëm me 5 ditë kur është absolutisht e nevojshme. Ky reduktim synon të adresojë vonesat “taktike” dhe ta bëjë informacionin të dorëzohet brenda një kohe që supozohet se ka ende vlerë publike.

Për të mos lënë rregullat në mëshirën e vullnetit të vetë institucioneve që u kërkohej transparencë, ligji i ri krijoi Komisionerin për të Drejtën e Informimit, një organ i posaçëm që merr vendime dhe zbaton sanksione ndaj institucioneve që nuk binden. Paralelisht, çdo autoritet duhet të ketë një koordinator të brendshëm për të drejtën e informimit si pikë unike kontakti dhe kujdestar i përditësimit të regjistrit.

Një tjetër gur themeli është “testi i proporcionalitetit” dhe “interesi publik” që nënkupton transparencën edhe kur kërkesa prek privatësinë, sekretin tregtar apo interesat e sigurisë, duke bërë që informacioni të jepet nëse interesi publik prevalon. Kjo e sjell Shqipërinë në linjë me standardet evropiane të proporcionalitetit.

Çështja e tarifave gjithashtu u rregullua. Dokumentet elektronike ofrohen teorikisht falas dhe

tarifat fizike nuk mund të tejkalojnë koston reale, duke ulur barrierat ekonomike për qytetarët dhe median.

Për më tepër, ligji 119/2014 hap mundësinë e përdorimit të portalit qeveritar e-Albania dhe detyrimin e publikimit online brenda 48 orësh të akteve që prekin liritë themelore, duke i integruar rregullat e informimit me realitetin dixhital.

Me pak fjalë, nga një kornizë formale dhe shpesh e paralizuar nga burokracia, Shqipëria kaloi në një sistem ku transparenca do të ishte proaktive, e shpejtë, e mbikëqyrur dhe e sanksionueshme. Mbushja e boshllëqeve mbeti sfidë, por mekanizmat, koordinatorët, Komisioneri, afatet e shkurtra dhe testi i interesit publik, tashmë në letër ekzistojnë. Pas dhjetë vitesh zbatim, raporti ynë mat sa fort kanë “kafshuar” këta dhëmbë të rinj dhe ku ende dhëmbin pak.

Në mënyrë të përmbledhur, tabela e mëposhtme paraqet ndryshimet mes dy ligjeve.

Fusha kryesore	Ligji 8503/1999	Ligji 119/2014	Pse përbën risi / përmirësim
Gama e autoriteteve të përfshira në detyrim për informim	Përfshin organet e administratës shtetërore dhe enteve publike	Përfshin organet kushtetuese, gjykatat, shoqëritë ku shteti ka shumicë aksionesh, si edhe persona/juridikë privatë që ushtrojnë funksion publik	Zgjeron fushën e transparencës. Përfshin edhe shoqëritë me shumicë kapitali shtetëror, si dhe subjekte private me funksione shtetërore
Transparenca proaktive	Publikim i disa udhëzimeve dhe listash informative (Nenet 8-9)	Programi i transparencës + regjistri i kërkesave/ përgjigjeve online (Nenet 4-8)	Kalon nga logjika “kërko për të marrë” në “publiko para se të ta kërkojnë”
Afatet procedurale	15 ditë për vendim refuzimi, 40 ditë kalendarike për përgjigjet (+10 ditë shtesë)	10 ditë pune për përgjigje; zgjatje max 5 ditë; refuzimi nënkuptohet pas kalimit të afatit	Përshejton aksesin dhe redukton hapësirën për vonesa
Mekanizëm i dedikuar kontrolli	Nuk ka organ të posaçëm; ankimi administrativ te organi epror + Avokati i Popullit	Krijohet Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e Dhënave, me fuqi vendimmarrëse dhe vendosje gjobash	Mbikëqyrje e specializuar, zbatim më i fortë
Sanksionet	Kundërvajtje të përgjithshme, pa shkallëzim konkret	Listë e detajuar shkeljesh (mospërditësim regjistri, tarifa abuzive, moskaktim koordinatorësh) me gjoba 25.000 – 300.000 lekë	E bën ligjin “me dhëmbë” dhe sanksionon përgjegjësinë personale
Koordinatori i të drejtës së informimit	Nuk parashikohet	Çdo institucion emëron një koordinator; kompetenca të përcaktuara (menaxhon regjistrin, ndihmon qytetarët)	Pikë unike kontakti, lehtëson komunikimin dhe mbikëqyrjen
Testi i proporcionalitetit të së drejtës për informim në raport me interesin publik	Rastet e përjashtimit pa “balancë”	Neni 17 lejon dhënien e informacionit edhe kur preken interesa të mbrojtur, nëse prevalon interesi publik	Siguron në teori standardin ndërkombëtar të proporcionalitetit
Tarifat dhe formatet	Tarifa vetëm për shpenzimet materiale; edhe kopjet elektronike mund të tarifohej	Informacioni elektronik falas; tarifat publike dhe të kontrolluara periodikisht nga Komisioneri; përjashtime sociale	Ul barrierat ekonomike, rrit barazinë në akses në informacion
Digjitalizimi	Nuk trajtohet	Detyrim publikimi online brenda 48 orësh për aktet që kufizojnë liritë; mundësimi i përdorimit të portalit e-Albania	Përputhje më e mirë me realitetin dixhital

3.2 Amendamenti nr. 78/2023

Pas shumë vitesh nga zbatimi, ligji 119/2014 u zbuluan shumë boshllëqe në praktikë. Për të mbushur këto boshllëqe, Kuvendi miratoi në shtator 2023 ligjin nr. 78/2023, që përmirësoi disa aspekte të ligjit bazë, pavarësisht se procesi kaloi përmes kundërshtimesh nga komuniteti i gazetarëve dhe nuk adresoi shumë probleme që ishin ngritur gjatë viteve nga aktorët që e përdorin ligjin, përfshirë edhe Res Publica.

Amendamenti qartësoi disa nocione që lidhen me kufizimet e informacionit, si të drejtat e autorit, patentat dhe sekretet tregtare, të cilët u përkufizuan duke iu referuar ligjeve sektoriale, në mënyrë që administrata dhe gjykatat të kenë një barometër më të qartë kur peshojnë interesin publik kundrejt mbrojtjes së këtyre interesave. Edhe termi “autoritet publik” u unifikuua me Kodin e Procedurave Administrative.

Për transparencën proaktive rregullat u shtrënguan, duke parashikuar që çdo program transparence duhet jo vetëm të publikohet në faqen zyrtare, por edhe të shënojë datën e përditësimit dhe të rifreskohet sa herë ndryshojnë të dhënat. Regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve, që më parë mund të përditësohej një herë në tremujor, tani duhet të rifreskohet së paku çdo muaj.

Risia më e dukshme ishte forcimi i Komisionerit për të Drejtën e Informimit. Përmes nenit të ri 9/1, ky organ fiton më shumë pavarësi, merr kompetenca hetimi dhe deklasifikimi, mund të rekomandojë heqjen e sekretit kur interesi publik e kërkon. Paralelisht, katalogu i gjobave u zgjerua, duke përfshirë mospërditësimin e programeve të transparencës, mosëmërimin e koordinatorit apo moszbatimin e vendimeve të Komisionerit, duke e bërë titullarin personalisht përgjegjës.

Edhe koordinatorët e së drejtës për informim fituan diçka. Institucionet duhet të njoftojnë menjëherë Komisionerin për çdo emërim apo largim, ndërsa koordinatorit i njihet një shtesë page për natyrën e veçantë të punës, duke e kthyer këtë funksion nga rol formal në një detyrë me motivim financiar. Për më tepër, çdo procedurë disiplinore ndaj koordinatorit duhet të kalojë nga filtri i Komisionerit, çka rrit mbrojtjen e pavarësisë së tyre.

Një tjetër hap përpara ishte zëvendësimi i konceptit të “refuzimit” me atë të “kufizimit”. Institucioni nuk mund të mbyllë krejt portën e informacionit. Ai mund të mos publikojë vetëm pjesët e dokumentit që mbulohen realisht nga përjashtimet. Kjo vendos në praktikë parimin e hapjes më të gjerë të mundshme.

Në fund, ndryshimet sollën edhe detyrimin vjetor që çdo autoritet t’i raportojë Komisionerit, brenda muajit janar, për gjithë aktivitetin e vitit paraparak mbi zbatimin e ligjit. Ky mekanizëm llogaridhënieje krijon një seri të rregullt të dhënash krahasuese që do t’i ushqejë analizat e ardhshme dhe presionin publik.

Me fjalë të tjera, amendamenti 78/2023 sqaroi kufizimet, përshpejtoi publikimin, i dha forcë mbikëqyrjes, motivoi koordinatorët dhe uli hapësirën për refuzime arbitrare. Këto ndryshime i hapin rrugën një dekade të dytë ku e drejta për informim pritet të jetë në teori më e prekshme dhe e detyrueshme.

3.3 Ratifikimi i Konventës së Tromsos nga Shqipëria

Një nga zhvillimet më të rëndësishme në dekadën e parë të zbatimit të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” është padyshim ratifikimi i Konventës së Tromsos, që është instrumenti i parë ndërkombëtar detyrues që garanton aksesin në dokumentet zyrtare.

Shqipëria e kishte nënshkruar Konventën e Tromsos që në vitin 2009, duke u pozicionuar politikisht si vend mbështetës i transparencës. Megjithatë, për më shumë se një dekadë, dokumenti nuk u ratifikua, duke e lënë vendin jashtë detyrimeve të drejtpërdrejta që ky instrument ndërkombëtar imponon. Vetëm në maj 2022, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 45/2022, duke formalizuar ratifikimin dhe duke e bërë Shqipërinë një nga vendet që i bashkohen kësaj nisme evropiane. Konventa hyri në fuqi në nivel ndërkombëtar në dhjetor 2020, pasi u ratifikua nga shteti i dhjetë (Ukraina).

Çfarë sjell Konventa e Tromsos? Ajo përcakton standarde të qarta dhe të avancuara për të drejtën e informimit, si:

- E drejta e çdokujt për akses në dokumente publike, pa diskriminim dhe pa nevojën për të justifikuar interesin.
- Kufizime proporcionale, të bazuara vetëm në një listë të mbyllur interesash legjitime (siguria kombëtare, privatësia, sekreti tregtar, etj.), gjithmonë të balancuara me testin e interesit publik.
- Detyrimi për transparencë proaktive – publikimi i dokumenteve kyçe pa prituri kërkesa nga qytetarët.
- Procedura efektive dhe afate të shpejta për trajtimin e kërkesave.
- Mekanizma të pavarur ankimore për të garantuar respektimin e të drejtës.

Ratifikimi i Konventës së Tromsos përbën një piketë historike për Shqipërinë, për disa arsye:

- Sjell harmonizim me standardet evropiane dhe e vendos Shqipërinë në një linjë me shtetet që kanë pranuar detyrime ndërkombëtare konkrete për aksesin në informacion.
- Shton presionin për zbatim. Edhe pse ligji nr. 119/2014 vlerësohej si një ndër më progresivët në botë, problemi kryesor ka qenë zbatimi i tij. Ratifikimi i Konventës i jep shoqërisë civile dhe aktorëve ndërkombëtarë një mjet shtesë presioni ndaj institucioneve publike.
- Në teori, qytetarët shqiptarë mund t’i referohen drejtpërdrejt Konventës për të kërkuar zbatimin e të drejtës së tyre për informacion.
- Rrit monitorimin ndërkombëtar pasi Shqipëria tashmë duhet të raportojë mbi zbatimin e saj para Grupit të Aksesit në Informacion (AIG) pranë Këshillit të Evropës, duke shtuar nivelin e llogaridhënies.

Fakti që Konventa u ratifikua nuk do të thotë se standardet e saj janë automatikisht të zbatuara. Raportet e viteve 2022–2024 tregojnë se (1) transparenca proaktive është ende e pjesshme dhe shpesh formale, (2) vendimet e Komisionerit nuk kanë forcën ekzekutive që do të kërkonte fryma e Konventës; (3) procedurat shpesh zgjasin shumë më tepër se afatet e parashikuara ligjorisht; (4) shumë kufizime në praktikë interpretohen në mënyrë të gjerë nga institucionet, duke cenuar parimin e proporcionalitetit.

Në vitin 2025, Access Info Group (AIG), si një trupë ekspertësh e pavarur e themeluar nën Konventën e Tromsos, publikoi raportin e parë bazë (baseline evaluation) për Shqipërinë.

Raporti vlerëson përputhshmërinë e ligjit shqiptar nr. 119/2014 për të drejtën e informimit, në versionin e përditësuar me ndryshimet pas ratifikimit të Konventës së Tromsës, me standardet që ajo vendos. AIG e bazoi vlerësimin e tij në dy parametra kryesorë:

- Përputhja ligjore: Nëse ligji shqiptar për të drejtën e informimit është i përshtatshëm me parimet e Konventës, për shembull, nëse kufizimet e ligjit (sekrete profesionale, siguria, privatësia, etj.) janë proporcionale dhe të lejuara sipas Konventës.
- Zbatimi praktik: Nëse ligji qëndron në letër apo aplikohet edhe në praktikë, pra, sa efektivisht zbatohen procedurat e aksesit në dokumente, nëse ekziston transparencë proaktive, etj.

Raporti AIG vlerësoi se ligji shqiptar është, në parim, në përputhje me standardet e Tromsës, por u rekomandoi autoriteteve të rivlerësojnë kufizimet e bazuara në sekretin profesional, të cilat sipas AIG mund të jenë përdorur në mënyrë tepër të gjerë.

3.4 Gjyqtarët e medias

Reforma në drejtësi (2016–2017) solli krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), i cili nisi funksionimin në dhjetor 2018. Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” dhe ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” parashikojnë pozicione të posaçme për komunikimin me median dhe publikun. Për çdo juridiksion apeli, KLGJ cakton të paktën një gjyqtar për median Ai/ajo ka rolin e ndërmjetësuesit institucional mes gjykatave dhe publikut.

Sipas nenit 46 të ligjit nr. 98/2016, gjyqtari për median:

- Informon publikun dhe median për veprimtarinë e gjykatave, duke respektuar të drejtën për informim.
- Përgatit përmbledhje të vendimeve gjyqësore me interes publik dhe i komunikon ato me gjuhë të kuptueshme.
- Siguron që vendimet gjyqësore të publikohen sipas ligjit dhe japë informacion për seancat me interes publik.
- Mban kontakte të vazhdueshme me median, duke shpjeguar proceset gjyqësore dhe duke korrigjuar keqinformimet.

Pra, gjyqtari i medias nuk është thjesht zëdhënës, por një figurë që garanton transparencë, profesionalizëm dhe besueshmëri në marrëdhëniet mes gjyqësorit dhe publikut.

Plani strategjik i komunikimit të KLGJ parashikon katër shtylla kryesore:

- Akses: Gjyqtarët e medias shpjegojnë ligjin në një gjuhë të thjeshtë dhe marrin pjesë në takime vjetore me gazetarët për të dëgjuar problematikat.
- Profesionalizmi: Ata caktohen për aftësitë etike, komunikative dhe për besimin e kolegëve.
- Besueshmëria: Jepet informacion i plotë dhe i saktë, duke respektuar mbrojtjen e të dhënave personale dhe parimin e pafajësisë.
- Mjetet e komunikimit: faqet e internetit të gjykatave, rrjetet sociale, buletine, konferenca vjetore “gjyqtar-media”, aktivitete “Gjykata e Hapur” etj.

Institucioni i gjyqtarit të medias është një risi e sistemit shqiptar të drejtësisë, e menduar për të rritur transparencën gjyqësore dhe për të ndihmuar gazetarët e qytetarët të kuptojnë më mirë

proceset gjyqësore. Megjithatë, nga monitorimet e deritanishme, ky mekanizëm përdoret ende shumë pak në praktikë. Vendimet gjyqësore anonimizohen, faqet e gjykatave shpesh nuk janë të përditësuara dhe gjyqtarët e medias nuk janë kthyer ende në pikën kryesore të aksesit publik.

3.5 Agjencia për Media dhe Informim

Agjencia për Media dhe Informim u krijua në vitin 2021 si një strukturë e re në varësi të Kryeministrit, me misionin e deklaruar për të garantuar transparencën e qeverisë dhe për të informuar publikun mbi politikat, projektet, aktivitetet dhe aktet kryesore të Këshillit të Ministrave dhe institucioneve të administratës shtetërore. Në aktin themelues ajo u paraqit si një instrument që do të ndërtonte ura komunikimi më të drejtpërdrejta me qytetarët dhe median, duke premtuar një standard të ri në fushën e transparencës.

Megjithatë, realiteti i tre viteve të funksionimit ka treguar një panoramë shumë më të varfër se pritshmëritë. Pavarësisht se AMI u krijua për të rritur aksesin në informacion, në praktikë ajo nuk ka arritur të luajë këtë rol. Vetëm 159 kërkesa për informacion janë trajtuar prej saj në harkun kohor të viteve 2021–2023, një numër tepër i ulët po të kemi parasysh se në të njëjtën periudhë mijëra kërkesa iu drejtuan institucioneve të tjera shtetërore. Kjo tregon se funksioni i saj mbetet minimal.


Për vitin 2024, Res Publica ka hasur në vështirësi të drejtpërdrejta për të marrë informacion nga kjo agjenci. Në rastet kur janë bërë kërkesa zyrtare pranë AMI, është dashur t'i drejtohem Komisionerit për të Drejtën e Informimit për të marrë përgjigjet, pasi vetë agjencia nuk i është përmbajtur afateve ligjore për dhënien e informacionit. Kjo sjellje bie ndesh me parimin themelor mbi të cilin u krijua vetë institucioni, që ishte garantimi i transparencës dhe aksesit të publikut në informacion.

Në planin më të gjerë, roli i AMI në drejtim të informimit publik mbetet i kufizuar dhe, sipas vlerësimeve të monitorimeve të pavarura, nuk e justifikon ekzistencën e saj si organ i veçantë për informim. Në vend që të jetë një urë lehtësuese për qytetarët dhe median, shpesh perceptohet si një filtër shtesë që centralizon informacionin dhe e bën atë më të vështirë për t'u marrë në mënyrë të pavarur.

Ky perceptim është reflektuar edhe në kritikën e shumta që janë ngritur nga gazetarë dhe organizata të shoqërisë civile. Sipas tyre, AMI nuk ka funksionuar si garantues i transparencës, por rrezikon të kthehet në një mjet të centralizimit të informacionit dhe të kontrollit të narrativës qeveritare. Media dhe organizatat kanë ngritur shqetësimin se, duke kaluar përmes AMI-së, informacioni jo vetëm vonohet, por shpesh selektohet dhe filtrohet, duke e bërë më të vështirë marrjen e të dhënave sensitive ose atyre me interes investigativ.

Pikërisht për këtë arsye, shumë gazetarë e kanë parë AMI jo si një mjet lehtësimi, por si një barrierë të re, e cila i shton burokracinë procesit të marrjes së informacionit dhe i jep qeverisë më shumë kontroll mbi mënyrën se si komunikohen politikat dhe aktet publike.

3.6 Vlerësimi i transparencës proaktive



3.7 Të dhënat e hapura dhe ripërdorimi i informacionit në sektorin publik

Ligji nr. 33/2022, i cili hyri në fuqi në prill 2023, është një shtesë e rëndësishme që plotëson kornizën e të drejtës për informim në Shqipëri. Ky ligj përcakton rregullat dhe procedurat për ripërdorimin e të dhënave të hapura, duke i lejuar individët, bizneset dhe shoqërinë civile të përdorin dokumentet publike për qëllime fitimi, inovacioni ose jo-fitimprurëse¹.

Me këtë ligj, secili autoritet publik është i detyruar të publikojë listën e dokumenteve që zotëron, që mund të ripërdoren, dhe të krijojë për to një rubrikë të aksesueshme online, koncepti i “të dhënave të hapura”². Megjithatë, monitorimi i Res Publica në 100 institucione për vitin 2024 tregon se vetëm 18 % prej tyre kanë pasur në faqen zyrtare këtë rubrikë, ndërkohë që 10 % e institucioneve e kanë krijuar por e lënë plotësisht bosh, duke e bërë aplikimin real të ligjit efektiv vetëm në 8 % të rasteve.

Kjo performancë tërësisht e ulët në zbatimin e ligjit ngre një presion të ri mbi institucionet publike. Një hap ligjor nuk mjafton, por duhet transformuar në mekanizëm real që funksionon për publikun.

Ligji synon përputhjen me standardet europiane sepse tashmë Shqipëria ka një legjislacion në linjë me Direktivën EU 2019/1024 mbi të dhënat e hapura, përfshirë krijimin e portalit nacional opendata.gov.al dhe infrastrukturën cloud për qeverisjen digjitale.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit mbikëqyr zbatimin e ligjit, përfshirë edhe pjesën e ripërdorimit të të dhënave, por efektiviteti në praktikë duket i kufizuar.

¹ Shih Relacion për projektligjin “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, aksesuar në linkun: <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/20201014122153RELACION%20-%20INFORMACIONI%20I%20SEKTORIT%20PUBLIK.pdf>

² Organi i sektorit publik përcakton listën e dokumenteve ekzistuese që mund të ofrohen në formatin e të dhënave të hapura, të cilën e bën publike. 4. Për qëllime të ripërdorimit të dokumenteve, organi i sektorit publik nuk është i detyruar të krijojë, të përshtat dokumente ose të ofrojë ekstrakte në ato raste kur kjo kërkon përpjekje të konsiderueshme shtesë dhe joproporcionale që shkojnë përtej funksionit të zakonshëm.”

Në kuadër të Planit Kombëtar të Veprimit (OGP 2022–2024), parësor është zhvillimi i politikës së të dhënave të hapura dhe konsolidimi i portalit e-Albania për ofrimin e shërbimeve digjitale të shpejta.

Disa institucione, si Gjykata e Lartë dhe disa gjykata të rretheve, kanë krijuar rubrika “Të dhënat e hapura” dhe publikojnë statistika, vendime, buxhete, etj. Edhe institucione të tjera, si Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM), kanë botuar listën e tyre të dhënave në zbatim të ligjit.

3.8 Platforma “Transparent Albania”

Më 13 dhjetor 2024, qeveria prezantoi publikisht platformën Transparent Albania, duke e paraqitur si një instrument të ri për forcimin e transparencës dhe llogaridhënies. Ky veprim u shënuar si një arritje institucionale e vitit 2024, për shkak të lidhjes së drejtpërdrejtë me të drejtën e informimit dhe përputhshmërinë me standardet evropiane në fushën e qeverisjes së hapur.

Megjithatë, nga një shqyrtim i përmbajtjes së faqes rezulton se platforma nuk ofron funksionalitete të reja apo vlera të shtuar përtej mekanizmave ekzistues. Ajo përfshin:

- Programe transparence të ministrive, por jo të të gjitha institucioneve publike, duke e kufizuar ndjeshëm gamën e informacionit.
- Link për të dhëna të hapura, të cilat publikohen në një portal ekzistues sipas ligjit nr. 33/2022.
- Link për ndjekjen e kërkesave për informacion, por ky funksion realizohet duke u adresuar te platforma e-Albania, pra nuk është element i ri.
- Linke për vendime të Këshillit të Ministrave dhe urdhra të Kryeministrit, të cilat edhe më parë kanë qenë të aksesueshme në faqen e Kryeministrit.
- Shpenzime buxhetore, të cilat në thelb janë pjesë e programeve të transparencës dhe nuk ofrojnë ndonjë shtesë të dukshme krahasuar me të dhënat e publikuara më parë.

Në këtë kuptim, platforma duket më shumë si një instrument komunikimi politik dhe propagandistik, i ndërtuar për të krijuar perceptimin se po bëhet një hap i rëndësishëm për transparencën, pa sjellë realisht risi në përmbajtje apo qasje. Ajo nuk përfshin mekanizma për monitorim të gjerë, nuk rrit ndjeshëm aksesin qytetar në informacion dhe nuk ofron të dhëna të strukturuar për gjithë institucionet publike.

Kjo tregon një prirje të përsëritur të qeverisë shqiptare për të shtuar fasadën e transparencës, në vend që të forcojë në thelb mekanizmat ligjorë dhe praktikë të së drejtës për informim. Për pasojë, edhe pse e pozicionuar si zhvillim i vitit 2024, platforma mbetet e kufizuar në ndikim dhe me vlerë të diskutueshme për qytetarët dhe shoqërinë civile.

3.9 Sa vlerë ka etiketa “ligji i gjashtë në botë“?

Sipas renditjes Global Right to Information Rating (RTI), zhvilluar nga Access Info Europe e këtij raporti.

dhe Centre for Law and Democracy, Shqipëria renditej në vendin e 75-të në botë në vitin 2014 dhe më pas, me miratimin e ligjit nr. 119/2014, u ngrit në vendin e 6-të. Në vitin 2024 pësoi rënie me një pozicion, duke u ulur në vendin e 7-të, por kjo ka pak rëndësi për qëllimet e këtij raporti.

Për shumë kohë, kjo renditje, “të gjashtë në botë” është përdorur për të treguar se Shqipëria ka zgjidhur problemet e transparencës dhe se shumë shtete të tjerë (përfshirë edhe të gjithë shtetet e BE-së) janë më keq se ne.

E vërteta është që indeksi RTI është një mënyrë vlerësimi e kuadrit ligjor në fushën e të drejtës së informimit. Ajo mbështetet mbi një set prej 61 indikatorësh, të ndarë në shtatë kategori kryesore, që së bashku japin një maksimum prej 150 pikësh. Indikatorët masin përkufizimin e të drejtës për akses, fushëveprimin e ligjit, procedurat e kërkesave, përjashtimet dhe refuzimet, mekanizmat e ankimit, sanksionet, mbrojtjet dhe masat promovuese.

Kur u aplikua kjo metodologji mbi ligjin shqiptar nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, rezultati ishte mbresëlënës: 127 pikë nga 150 të mundshme. Kjo e vendoste Shqipërinë mes vendeve me ligje më të avancuara në botë përsa i përket qartësisë dhe progresivitetit të kuadrit ligjor, menjëherë pas shteteve të përparuar si Afganistani (139 pikë), Meksika (136 pikë), Serbia (135 pikë), Sri Lanka (131 pikë), Sllovenia (128 pikë) dhe së fundi edhe Gambia (128 pikë), ndërsa shumë shtete të prapambetur si Spanja (73 pikë), Franca (66 pikë), Austria (64 pikë), Danimarka (64 pikë), Belgjika (59 pikë) e Gjermania (55 pikë), janë në listën e kuqe... Pak paradoksale apo jo?

Në fakt, kjo nuk ka të bëjë fare me transparencën në praktikë. Arsyet kryesore që sollën këtë rezultat të lartë të Shqipërisë lidhen me disa elementë themelorë të ligjit. Së pari, ligji shqiptar ka një përkufizim shumë të gjerë të informacionit publik, duke përfshirë jo vetëm dokumentet klasike të administratës, por edhe formatet moderne si e-mail-et apo mesazhet elektronike. Së dyti, ai ka vendosur procedura të qarta dhe afate të shpejta për përgjigje, vetëm 10 ditë, krahasuar me afatën shumë më të gjatë prej 40 ditësh që ekzistonte më parë. Së treti, ligji krijoi një institucion të posaçëm monitorues (Komisionerin për të Drejtën e Informimit), i pajisur me kompetenca për të ndëshkuar administratën në rast shkeljesh. Për më tepër, ligji parashikon sanksione administrative ndaj zyrtarëve që refuzojnë padrejtësisht dhënien e informacionit, duke shtuar kështu një mekanizëm presioni për zbatim.

Pra, ligji shqiptar ka marrë një vlerësim shumë të lartë sepse synon të garantojë një të drejtë të gjerë dhe progresive për akses në informacion, vendos rregulla të qarta dhe afate të shpejta, si dhe parashikon një autoritet të pavarur mbikëqyrës. Por, për të arritur maksimumin e standardeve ndërkombëtare, do të duhej të përmirësoheshin mekanizmat për testin e dëmit, të saktësoheshin procedurat për palët e treta dhe të kufizohej përdorimi i përjashtimeve të gjera si “sekreti tregtar”. E njëjta gjë ndodh edhe me ligjet e Afganistanit apo Gambias, sepse kanë bërë ligje të kohëve të fundit, të përshtatshëm me teknologjinë dhe parimet e fundit, si dhe shumë lehtësisht të premtueshëm në letër.

Në thelb, Access Info e sheh Shqipërinë si një shembull të një ligji të mirë në teori, por që, siç tregohet nga monitorimet e organizatave vendore, vazhdon të përballlet me sfida serioze në zbatim. Dhe pikërisht, për këtë arsye, ky raport do të përmbajë informacione për një periudhë 10 vjeçare dhe do të fokusohet në risitë dhe përmirësimet kryesore që sollën ligji

119/2014 dhe amendamenti 78/2023 dhe që mund të maten përmes monitorimit, si:

1. Programet e transparencës
2. Regjistri elektronik i kërkesave/përgjigjeve
3. Koordinator i së drejtës për informim
4. Afati i kthimit të përgjigjeve
5. Vendimet e Komisionerit, vendosja e sanksioneve
6. Raste nga praktika e vitit të fundit

IV. TRANSPARENCA E AUTORITETEVE PUBLIKE

4.1 Vlerësimi i transparencës proaktive

Një dekadë pas hyrjes në fuqi të ligjit 119/2014, transparenca proaktive mbetet një pikë e rëndësishme ku shihet se sa seriozisht e marrin institucionet kultivimin e llogaridhënies publike. Për vitin 2024 Res Publica monitoroi 100 autoritete publike nga pesë kategori (20 autoritete kushtetuese / të pavarur, 20 autoritete të pushtetit ekzekutiv qendror, 20 autoritete të pushtetit ekzekutiv të vartësisë, 20 autoritete të pushtetit vendor, si dhe 20 autoritete të drejtësisë), duke i krahasuar gjetjet me serinë historike 2015-2023, për të cilët është bërë një monitorim i ngjashëm, duke ruajtur metodologjinë të pandryshuar.

a) Programet e transparencës

Që nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 119/2014, programet e transparencës kanë qenë një tregues i qartë i mënyrës se si autoritetet publike e kuptojnë dhe e zbatojnë detyrimin për transparencën proaktive. Në vitet e para, përmbushja e këtyre programeve ishte minimale. Raporti i vitit 2015 tregonte se vetëm një pjesë shumë e vogël e institucioneve (rreth 18%) kishin arritur t'i përmbushnin detyrimet në një nivel “të kënaqshëm”. Edhe në vitet në vijim, ritmi i përmirësimit ishte i ngadaltë, duke u shoqëruar me raste të shumta kur programet ishin formale, të papërditësuara ose nuk pasqyronin informacion të dobishëm për publikun.

Një kthesë e dukshme nisi të vihej re pas vitit 2020, kur raportet tregojnë se përmbushja e kënaqshme e programeve filloi të rritej në mënyrë më të ndjeshme. Kjo lidhet me veprimtarinë e Komisionerit për të Drejtën e Informimit, i cili, pas presionit publik nga shoqëria civile dhe gazetarët, shtoi masat administrative dhe gjobat për mospërmbushje. Pikërisht, kur nisi zbatimi i gjobave u konstatua një përmirësim i ndjeshëm i programeve të transparencës.


Në vitin 2024, monitorimi i qendrës Res Publica i 100 institucioneve publike më të rëndësishme, tregoi se progresi kishte vijuar, edhe pse jo me ritme të shpejta. Rreth 65%

e institucioneve arritën një përmbushje “të kënaqshme” të programeve të transparencës, ndërsa për herë të parë u evidentua se rreth 3% e tyre shënonin edhe datën e çdo përditësimi të programit, siç e kërkojnë ndryshimet ligjore të vitit 2023. Kjo është një shifër ende shumë e ulët, por tregon një fillim të zbatimit të standardit të ri, që synon të garantojë freskinë e informacionit të publikuar.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit, gjatë vitit 2024, ka nxjerrë 24 rekomandime dhe ka vendosur 4 gjopa ndaj institucioneve për mospublikim ose mospërditësim të programeve. Këto masa tregojnë qartë se sanksionet mbeten instrumenti më efektiv për të shtyrë administratën të respektojë ligjin. Ky trend është i njëjtë me vitet e mëparshme (2020-2023), ku raportet kanë vënë re se pa ndëshkim real, shumë autoritete publikojnë vetëm dokumente minimale ose të vjetruara, duke e bërë programin e transparencës një listë formale pa vlerë praktike për qytetarët.

Në perspektivën e dhjetë viteve, mund të thuhet se transparenca proaktive në këtë aspekt ka përjetuar një rritje graduale prej rreth 30 pikësh përqindjeje, por progresi mbetet i vogël dhe i pamjaftueshëm. Disa kategori institucionesh, sidomos ato kushtetuese dhe të pavarura, kanë shfaqur më shumë kujdes, ndërsa pushteti vendor ka qenë shpesh më prapa në zbatim. Sfidë kryesore sot nuk është më ekzistenca e programeve, por cilësia dhe përditësimi i tyre, që ende mbeten larg standardeve evropiane.

Grafiku krahasues 2015–2024



Siç shfaqet në grafik, në vitin 2024 ka një përmirësim të përmbushjes së programeve të transparencës, duke ndjekur të njëjtin trend pozitiv të nisur nga viti 2020 kur rezultojnë që vetëm 18% e autoriteteve kishin përmbushur kënaqshëm programin e transparencës, duke u rritur çdo vit me rreth 10% deri në vitin 2023, ndërsa në vitin 2024 vihet re një rritje prej 18 pikësh.


Numri i autoriteteve publike që nuk kanë program transparence mbetet në të njëjtat shifra dhe përmirësimi rezulton vetëm te autoritetet që e kanë një program të tillë.

Me gjithë përmirësimin e sipërpërmendur në vitet e fundit, situata mbetet ende problematike. Ndër 100 autoritetet publike më të rëndësishëm në vend, ende një e dhjeta e tyre nuk kanë fare një program transparence, ndërsa shumë autoritete të tjerë kanë përmbushur pjesërisht programet e transparencës.

Sërish, edhe në vitin 2024, vetëm një autoritet publik ka përmbushur plotësisht programin dhe ky është vetë Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.


Në fund të dekadës së matur, në vitin 2024, niveli i përgjithshëm rezulton të jetë rritur në masën 52.5% nga 47.7% që ishte në vitin 2023. Rritja vijon që prej vitit 2021 kur nisi zbatimi i gjobave, siç rezulton në grafikun në vazhdim:

Grafiku krahasues 2017-2024



Sipas llojit të autoriteteve, gjendja gjatë vitit 2024 paraqitet si më poshtë:

Programet e transparencës sipas institucioneve (%)



Grupi i autoriteteve kushtetues dhe të pavarur ka qenë historikisht në krye të renditjes dhe vazhdon të tregojë rezultatet më të mira. Nga 53% në vitin 2022, u rrit në 64% në vitin 2024, duke reflektuar një konsolidim gradual dhe relativisht të qëndrueshëm. Kjo tregon një kulturë më të konsoliduar transparence dhe një nivel më të lartë përgjegjshmërie krahasuar me kategoritë e tjera.

Kategoria e pushtetit ekzekutiv qendror ka shënuar një përmirësim të lehtë në vitin 2024, ndërkohë që ky rezultat mbetet i ulët për kategorinë e autoriteteve publike që administrojnë pjesën më të madhe të politikave dhe buxheteve publike, duke e bërë deficitin e transparencës këtu veçanërisht problematike.

Autoritetet e varësisë së pushtetit ekzekutiv kanë shfaqur më në fund një përmirësim të dukshëm. Nga 29% në vitin 2022, ata arritën në 56% në vitin 2024, një rritje prej 27 pikësh përqindjeje. Ky është progresi më i madh krahasuar me kategoritë e tjera dhe tregon se struktura të cilat dikur ishin më të mbyllura kanë nisur të përshtaten më mirë me standardet e transparencës.

Pushteti vendor paraqet një situatë të paqëndrueshme. Nga 38% në 2022 dhe 43% në 2023, ka rënë në 41% në vitin 2024, duke dëshmuar një përkeqësim të lehtë. Duke qenë se pushteti vendor ka një ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e përditshme të qytetarëve, kjo mbetet një nga pikat më të dobëta në zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit.


Kategoria e pushtetit gjyqësor dhe institucioneve të drejtësisë ka përjetuar një përmirësim të vazhdueshëm, nga 35% në 2022 në 54% në 2024. Kjo rritje është veçanërisht e rëndësishme, duke qenë se transparenca në këtë sektor është themelore për ndërtimin e besimit publik në sistemin e drejtësisë.

Ndër autoritetet publike të këtyre kategorive, shembujt konkretë pozitivë dhe negativë për vitin 2024 janë sipas tabelës së mëposhtme:

Shembujt pozitivë dhe negativë

Kategoria	Shembulli më pozitiv	Shembulli më negativ
Kushtetuese & të pavarura	Komisioneri për të Drejtën e Informimit	Presidenti i Republikës
Ekzekutivi qendror	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët
Ekzekutivi vartësie	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale	Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë
Pushteti vendor	Bashkia Shkodër	Bashkia Kukës
Drejtësia	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

Llojet e informacionit të kërkuar



b) Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve

Një nga elementët më të rëndësishëm të transparencës proaktive është ekzistenca e regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve, që i mundëson publikut të njihet me kërkesat e mëparshme dhe reagimin e institucioneve pa pasur nevojë të ndjekë procedurën nga e para. Ky mekanizëm është menduar si një mjet për të rritur efikasitetin administrativ, për të shmangur përsëritjen e kërkesave të ngjashme dhe për të ofruar një nivel më të lartë llogaridhënieje.

Megjithatë, të dhënat e monitorimeve përgjatë dhjetë viteve tregojnë se zbatimi i tij ka qenë i vështirë dhe shpesh herë formal. Në dy vitet e para pas hyrjes në fuqi të ligjit (2015–2016), mbi 90% e autoriteteve publike nuk kishin asnjë regjister të tillë të publikuar. Një ndryshim i dukshëm u vu re në vitin 2017, kur kjo shifër ra në 47%, duke shënuar një përmirësim thelbësor, por pa një konsolidim të menjëhershëm në vitet që pasuan. Nga 2018 deri në

2020, përqindja e institucioneve pa regjistër mbeti pothuaj e pandryshuar, duke dëshmuar një ngecje të progresit.

Situata filloi të përmirësohej vetëm pas vitit 2021, kur përqindja e institucioneve pa regjistër ra në 23%, duke vijuar me një ulje të mëtejshme në 20% në vitin 2023. Monitorimi i vitit 2024 tregoi një përmirësim të lehtë, me 18% të autoriteteve publike që ende nuk kishin një regjistër të tillë, ndërsa pjesa tjetër vazhdonte të ishte e ndarë në disa kategori:


- një grup i kufizuar institucionesh ofronin akses të plotë mbi kërkesat dhe përgjigjet,
- një pjesë tjetër ofronin vetëm përmbledhje minimale, shpesh pa dokumentet shoqëruese,
- ndërsa shumë institucione e kishin regjistrin të paplotësuar ose me të dhëna të pjesshme.

Ky realitet tregon se, edhe pse numri i institucioneve që nuk e kanë fare regjistrin është reduktuar ndjeshëm gjatë dekadës, cilësia e regjistrave ekzistues mbetet e ulët. Për publikun, kjo do të thotë se aksesueshmëria në informacion është shpesh e kufizuar. Qytetarët shohin vetëm një listë kërkesash pa përmbajtje ose një dokument me të dhëna minimale, duke mos i shërbyer qëllimit të ligjit për transparencë dhe efikasitet.

Në këtë kuptim, problemi nuk është vetëm ekzistenca e regjistrit, por funksionaliteti i tij. Një regjistër formal, pa të dhëna reale dhe pa përgjigje të aksesueshme, nuk arrin të përmbushë rolin për të cilin është konceptuar. Pikërisht për këtë arsye, ndryshimet e vitit 2023 në ligjin nr. 119/2014 vendosën një standard më të qartë, duke detyruar që regjistri të përditësohet së paku një herë në muaj dhe të ofrojë akses mbi dokumentet e dhëna.

Megjithatë, testimet e vitit 2024 tregojnë se ky detyrim nuk ka hyrë ende në praktikë. Shumica e institucioneve vazhdojnë të publikojnë të dhëna të pjesshme dhe vetëm një pakicë ofron transparencë reale. Kjo konfirmon se edhe pse progresi sasior është i dukshëm, nga mbi 90% mungesë regjistri në vitet e para në vetëm 18% në vitin 2024, progresi cilësor mbetet larg pritshmërive, duke e bërë regjistrin një nga sfidat kryesore të dekadës së parë të ligjit.

Grafik krahasues 2015-2024



c) Koordinatorët për të drejtën e informimit

Ligji nr. 119/2014 i ka dhënë një rëndësi të posaçme rolit të koordinatorit për të drejtën e informimit, i cili duhet të shërbejë si pikë unike kontakti mes qytetarëve dhe institucionit publik. Ky funksion nuk është thjesht formal sepse koordinatorët janë përgjegjës për menaxhimin e regjistrit të kërkesave e përgjigjeve, për ndihmën e qytetarëve në formulimin e kërkesave dhe për garantimin e respektimit të afateve ligjore. Në teori, pra, koordinatorët janë “rojtari i parë” i transparencës në çdo institucion.

Monitorimet e viteve të para pas hyrjes në fuqi të ligjit treguan mangësi të theksuara në emërimin e koordinatorëve. Shumë institucione ose nuk kishin caktuar një person të tillë, ose nuk e kishin bërë publik emrin dhe kontaktet e tij. Pas vitit 2017, ky tregues filloi të përmirësohej, kryesisht si rezultat i presionit publik dhe ndërhyrjeve të Komisionerit, i cili ka përsëritur shpesh se caktimi i koordinatorëve është një nga detyrimet themelore të ligjit.

Megjithatë, progresi ka qenë i brishtë dhe jo i qëndrueshëm. Deri në vitin 2023, rreth 10% e institucioneve vijonin të mos kishin një koordinator të caktuar, ose nuk i publikonin kontaktet, gjë që i bënte praktikisht të paarrtshëm për publikun.

Të dhënat e monitorimit të vitit 2024 tregojnë një regres shqetësues. Përqindja e institucioneve që nuk kishin emëruar koordinator, ose nuk e kanë publikuar këtë fakt, arriti në 17%, një rritje prej gati 7 pikësh krahasuar me vitin e kaluar. Për më tepër, 15% të institucioneve të tjerë, që kanë publikuar emërimin e koordinatorëve, nuk kanë publikuar të dhënat e kontaktit si numër telefoni apo adresë e-mail. Kjo do të thotë se, edhe pse në letër detyrimi formalisht është plotësuar, në praktikë qytetarët nuk mund t'i përdorin këta koordinatorë për t'u drejtuar me kërkesa.

Ky zhvillim tregon se një pjesë e administratës publike e trajton ende koordinatorin si një formalitet burokratik dhe jo si një hallkë thelbësore të transparencës. Në mungesë të një koordinator të aksesueshëm, qytetarët janë të detyruar të përballen me pengesa të panevojshme, të cilat çojnë shpesh në refuzime apo vonesa në marrjen e informacionit.

Kjo situatë bie ndesh me frymën e amendamenteve të vitit 2023, të cilat parashikuan që çdo autoritet të njoftojë menjëherë Komisionerin për çdo ndryshim koordinatorësh, si dhe i dhanë këtij funksioni një shtesë page për shkak të natyrës së veçantë të punës, me synim forcimin e pavarësisë dhe motivimit financiar të tyre. Fakti që, pavarësisht këtyre nismave, një pjesë e madhe e institucioneve nuk zbatojnë ende detyrimin, tregon për mungesën e presionit real zbatues.

Në një dekadë zbatim të ligjit, roli i koordinatorëve ka mbetur një nga pikat e dobëta të transparencës proaktive. Përmirësimet ligjore nuk janë shoqëruar me përmirësime të matshme në praktikë. Për këtë arsye, rekomandohet që Komisioneri të përdorë më shpesh instrumentin e gjobave dhe të krijojë një regjister publik të koordinatorëve të certifikuar, i cili të përditësohet në kohë reale dhe të shërbejë si burim verifikimi për qytetarët. Vetëm në këtë mënyrë ky funksion mund të marrë seriozisht rolin që i ka dhënë ligji.

d) Data e përditësimit

Një nga risitë më të rëndësishme të amendamentit nr. 78/2023 ishte vendosja e detyrimit që çdo dokument i përfshirë në programin e transparencës të shoqërohet me datën e fundit të ndryshimit. Kjo dispozitë synon të zgjidhë një nga problemet kronike të transparencës proaktive, faktin që shumë dokumente mbeten për vite të tëra në faqet zyrtare të institucioneve pa asnjë tregues se kur janë publikuar apo përditësuar. Si pasojë, qytetarët shpesh përballen me informacion të vjetëruar dhe nuk kanë asnjë mënyrë për të verifikuar sa i besueshëm është ai.

Në parim, ky standard i ri përbën një hap të madh drejt rritjes së besueshmërisë dhe llogaridhënies. Publikimi i datës së përditësimit i jep përdoruesit mundësinë të kuptojë nëse të dhënat mbi buxhetin, prokurimet apo raportet e auditimit janë ende të vlefshme, apo kanë mbetur thjesht si dokumente të arkivuara. Për më tepër, ky mekanizëm e vë administratën nën presionin e një kontrolli publik të vazhdueshëm, pasi qytetarët mund të evidentojnë menjëherë vonesat në përditësim.

Megjithatë, testimi i vitit 2024 tregoi se ky detyrim pothuaj nuk zbatohet. Nga 100 institucionet e monitoruara, vetëm 3% kishin të publikuar datën e përditësimit pranë dokumenteve të programeve të transparencës. Kjo do të thotë se shumica dërrmuese e faqeve zyrtare vazhdojnë të paraqesin informacion “statik”, duke e lënë publikun pa garanci se sa i freskët është materiali i publikuar.

Ky rezultat është tregues i një hendeku të madh mes normës ligjore dhe praktikës administrative. Edhe pse amendamenti synoi të sjellë qartësi dhe rritje të standardeve, administrata publike nuk ka bërë investimet teknike dhe organizative të nevojshme për zbatimin e tij. Shumë faqe zyrtare nuk kanë as funksionalitetin bazë për të shfaqur automatikisht datën e përditësimit, çka tregon se problemi nuk është vetëm mungesë vullneti, por edhe mungesë kapacitetesh.

Në këtë kuadër, Komisioneri për të Drejtën e Informimit duhet të ketë një rol më aktiv jo vetëm për të vendosur gjopa, por edhe për të ofruar udhëzime praktike dhe mbështetje teknike për institucionet. Ndryshe, ekziston rreziku që ky standard të mbetet thjesht një normë e shkruar, pa ndikim real mbi cilësinë e informacionit që i ofrohet publikut.

4.2. Sjellja e institucioneve ndaj kërkesave për informacion

Res Publica ndër vite ka monitoruar dhe testuar sjelljen e institucioneve ndaj kërkesave për informacion (transparenca reaktive). Elementet e monitoruar në këtë kontekst lidhen me përgjigjen ose refuzimin ndaj kërkesave për informacion, afatin për kthimin e përgjigjes, sjelljen e institucionit pas ankimit administrativ, etj. Në mënyrë që të kemi një analizë më efektive krahasimore ndër vite, do të merret në analizë i njëjti numër prej 200 kërkesash të trajtuara nga Res Publica.

Në mënyrë të përmbledhur janë monitoruar komponentët:

- Fusha e informacionit të kërkuar
- Kategoria e institucioneve të pyetur
- Sasia dhe cilësia e përgjigjeve ndaj kërkesës fillestare
- Kohëzgjatja e kthimit të përgjigjes pas kërkesës fillestare

- Reagimi i institucioneve pas ankimit administrativ te Komisioneri
- Kohëzgjatja e kthimit të përgjigjes pas depozitimit të ankimit administrativ


a) Fusha e informacionit të kërkuar

Kategoria për të cilën është kërkuar informacion është i fushave të ndryshme, duke përfshirë edhe informacione sensitive apo me interes të lartë publik, informacione të cilat autoritetet publike hezitojnë ti bëjnë publike.

Për vitin 2024 është kërkuar informacion në fushat si më poshtë:

- Kulturë
- Mjedisi
- Ndërtim
- Ekonomi
- Rindërtim
- Drejtësi
- Shëndetësi
- Prokurime publike, etj

b) Reagimi i institucioneve ndaj kërkesave fillestare



Nga 200 kërkesa për informacion të dërguara gjatë vitit 2024, rezultatet ishin si më poshtë:

- 62% përgjigje të plota
- 9% përgjigje të pjesshme
- 29% mospërgjigje

Edhe pse ligji "Për të drejtën e informimit" ka hyrë në fuqi prej dhjetë vitesh, fakti që në gati 1/3 e rasteve institucionet nuk japin asnjë përgjigje tregon se refuzimi mbetet një problem serioz dhe i rrënjosur. Kjo sjellje jo vetëm që bie ndesh me frymën e ligjit, por i shndërron kërkesat për informacion në një proces të pasigurt, ku qytetari nuk ka garanci se do të marrë një reagim, pavarësisht detyrimit ligjor.


Krahasuar me vitin 2023, ku niveli i përgjigjeve të plota ishte 67% dhe përgjigjet e pjesshme 6%, ndërsa mospërgjigja 27%, ka një regres të lehtë. Rënia prej 5 pikësh në përgjigjet e plota dhe rritja e mospërgjigjeve tregojnë se vullneti i institucioneve për të trajtuar kërkesat ka shënuar një dobësim. Në vend që prirja të ishte progresive dhe e qëndrueshme, vihet re një lëkundje nga viti në vit, gjë që tregon mungesë konsistence në respektimin e ligjit.

Nëse i referohemi dekadës, krahasimi tregon një përmirësim relativ. Në vitin 2015, vetëm gjysma e informacionit të kërkuar bëhej publik, ndërsa sot shifra e përgjigjeve të plota dhe të pjesshme së bashku arrin në 71%. Ky progres është i dukshëm në aspektin sasior, por jo i mjaftueshëm për të konsideruar se ligji ka arritur objektivin e tij, që është transparenca e plotë dhe e garantuar.

Nga njëra anë, shifrat e vitit 2024 tregojnë se rezistenca institucionale nuk është thyer ende. Nga ana tjetër, krahasuar me situatën e dhjetë viteve më parë, është bërë një rrugë e gjatë drejt një niveli disi më të lartë të përgjegjshmërisë. Problemi mbetet se ky përmirësim nuk ka ardhur në mënyrë lineare dhe të qëndrueshme, por është shoqëruar me luhatje që shpesh varen nga presioni i aktorëve të jashtëm (shoqëria civile, media, Komisioneri) dhe jo nga një kulturë e brendshme institucionale e transparencës.

Për të kaluar në një fazë të re, ku transparenca të bëhet standard dhe jo përjashtim, kërkohet forcim i mekanizmave detyrues, veçanërisht për sanksionimin e mospërgjigjes dhe për transformimin e transparencës në një kulturë pune të institucioneve publike.

c) Kohëzgjatja e kthimit të përgjigjeve ndaj kërkesave fillestare



Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” parashikon qartë se çdo institucion publik është i detyruar të kthejë përgjigje brenda 10 ditëve pune nga momenti i paraqitjes së një kërkesë për informacion, me mundësinë e shtyrjes vetëm për 5 ditë të tjera në raste të veçanta dhe të justifikuara. Ky afat është menduar si një garanci që informacioni të ketë ende vlerë praktike dhe aktuale për qytetarin.

Gjatë vitit 2024, monitorimi tregon se koha mesatare e kthimit të përgjigjeve ka qenë 18 ditë kalendarike, pra disa ditë më gjatë se afati maksimal i përcaktuar me ligj (10 ditë pune, ose afro 14 ditë kalendarike). Kjo është një shifër që, në krahasim me vitin 2023 (23 ditë kalendarike), paraqet një përmirësim prej 5 ditësh. Megjithatë, pavarësisht progresit, afati ligjor nuk respektohet në mesatare, çka e bën të drejtën për informim shpesh të cunguar.


Nëse krahasohet me dhjetë vitet e fundit, vihet re një luhajtje e konsiderueshme. Në vitin 2015, kohëzgjatja mesatare ishte 15 ditë. Në vitet pasues ajo ka pësuar rritje të ndjeshme, duke arritur në nivele rekord në 2021 (27 ditë), përpara se të shënonte ulje të pjesshme në vitet e fundit. Pra, edhe pse në krahasim me periudhën më problematike situata ka përmirësim, sot jemi ende më keq se në vitin e parë të zbatimit të ligjit.

Ky tregues nxjerr në pah dy dukuri:

- Mungesa e respektimit të normave ligjore, edhe kur institucionet janë të gatshëm të japin informacion. Në shumë raste, vonesa nuk lidhet me refuzimin, por me një administrim të ngadalshëm dhe joefikas të kërkesave.
- Mungesa e përgjegjësiive individuale sepse ligji parashikon sanksione për tejkalimin e afateve, por ato rrallëherë aplikohen, duke bërë që praktika e vonesave të vazhdojë pa pasoja reale.

Edhe pse në vitin 2024 kemi një përmirësim krahasuar me vitin pararendës, fakti që mesatarja qëndron pothuaj dyfish mbi afatin ligjor tregon se transparenca institucionale në Shqipëri vijon të mbetet më shumë një përjashtim se sa një standard. Kjo situatë i zbeh efektet e ligjit dhe kufizon aftësinë e qytetarëve, gazetarëve dhe organizatave për të përdorur informacionin në kohë reale.

d) Reagimi i institucioneve pas dorëzimit të ankimit administrativ



Një nga mekanizmat kryesorë për garantimin e zbatimit të ligjit është ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ky instrument u krijua për të ofruar një zgjidhje më të shpejtë dhe më pak të kushtueshme se sa ndjekja e një gjykimi, duke vënë institucionet publike nën një presion të drejtpërdrejtë për të korrigjuar shkeljet.


Të dhënat e vitit 2024 tregojnë se 89% e institucioneve kanë kthyer përgjigje pas dorëzimit të një ankese pranë Komisionerit. Ky është niveli më i lartë i katër viteve të fundit, duke sinjalizuar një efektivitet më të madh të ankimit administrativ. Në praktikë kjo do të thotë se, edhe kur një institucion refuzon ose vonon të përgjigjet fillimisht, një pjesë e konsiderueshme e tyre detyrohen të veprojnë sapo përfshihet autoriteti mbikëqyrës.

Nëse shohim serinë shumëvjeçare, vihet re se ky indikator ka pasur luhatje të mëdha. Ka pasur vite kur përgjigjet pas ankimit kanë qenë në nivelin 75–80%, dhe vite të tjera kur shifra i është afruar 90%. Kjo tregon se nuk ka një trend të qartë progresiv, por më tepër një sjellje të paqëndrueshme të institucioneve publike. Kësisoj, rezultati i vitit 2024, sado pozitiv, duhet marrë me rezervë: nuk ka garanci se ky nivel do të mbahet i qëndrueshëm në të ardhmen.

Ky variabilitet sugjeron se respektimi i detyrimeve ligjore nuk është i brendësuar si kulturë institucionale, por shpesh varet nga rrethana të rastit, përfshirë presionin e veprimeve më të forta të Komisionerit ndër vite.

Fakti që përqindja është e lartë në 2024 është inkurajues, por pa një konsistencë ndër vite mbetet e paqartë nëse kjo është shenjë e një ndryshimi real apo thjesht një rastësi e përkohshme.

e) Kohëzgjatja e reagimit të institucioneve pas ankimit administrativ



Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit është konceptuar si një mekanizëm i shpejtë për të korrigjuar refuzimet apo vonesat e institucioneve publike.

Pas paraqitjes së një ankese, praktika e deritanishme tregon se shumë institucione, të cilat më parë kanë refuzuar ose nuk kanë kthyer përgjigje, lëvizin dhe japin informacionin e kërkuar vetëm pasi ndihen nën presionin e Komisionerit.

Sipas monitorimit, kohëzgjatja mesatare e përgjigjes pas ankimit administrativ në vitin 2024 ka mbetur pothuajse e pandryshuar krahasuar me vitet e fundit. Në katër vitet e fundit (2021–2024), koha mesatare e reagimit të institucioneve pas ankimit është luhatur vetëm me diferenca të vogla, që nuk mund të konsiderohen domethënëse. Kjo tregon se administrata nuk ka bërë hapa të dukshëm për të përshpejtuar procesin, pavarësisht se ka pasur përmirësime të pjesshme në cilësinë e përgjigjeve fillestare.


Ndër vite, ky tregues ka qenë rreth 20–25 ditë kalendarike, me variacione të vogla, duke dëshmuar se edhe kur ankimi funksionon, qytetari ose gazetari shpesh përballet me një pritje të gjatë për të marrë informacionin.

Këto të dhëna sugjerojnë dy problematika të mëdha:

- Së pari, institucionet reagojnë vetëm nën presion, jo për shkak të një kulture të brendshme transparence.
- Së dyti, afatet ligjore nuk respektohen në praktikë. Edhe kur Komisioneri ndërhyr, vonesat mbeten të zakonshme, duke dëmtuar efektivitetin real të së drejtës për informim.

Viti 2024 konfirmon se kohëzgjatja e reagimit të institucioneve pas ankimit administrativ mbetet në nivele të ngjashme me vitet e fundit, pa ndonjë përmirësim të dukshëm. Problemi nuk lidhet me njohjen e ligjit, por me mungesën e mekanizmave të fortë zbatues dhe të një vullneti të qëndrueshëm për transparencë.

f) Vlerësim agregat



Grafiku tregon shpërndarjen e rezultateve pas 200 kërkesave për informacion. Shumica e kërkesave marrin përgjigje brenda mesatarisht 18 ditësh, ndërsa një pjesë tjetër marrin përgjigje më të vonshme, pas ankimit te Komisioneri, duke pritur rreth 41 ditë kalendarike. Një pjesë shumë e vogël, vetëm 2%, nuk marrin përgjigje as pas këtij procesi dhe përfundojnë në Gjykatën Administrative, ku koha e zgjidhjes mund të zgjasë me vite.

Edhe pse përqindja e rasteve që përfundojnë në gjykatë është e vogël (2%), pikërisht këto raste përfaqësojnë informacionet më të rëndësishme për publikun. Zakonisht bëhet fjalë për dokumente që lidhen me kontrata koncesionare, prokurime publike, tendera të mëdhenj apo vendimmarrje me ndikim në interesin publik. Janë këto kërkesa që paraqiten kryesisht nga gazetarë investigues dhe organizata të shoqërisë civile, të cilët kërkojnë të zbardhin praktikën më të diskutueshme të administratës.

Pra, ndërsa statistikën e përgjithshme mund të krijojnë idenë e një sistemi funksional, realiteti është se aty ku testi është më i fortë, te informacionet me peshë të lartë publike, sistemi dështon. Qytetarët dhe gazetarët duhet të përballen me vite procesesh gjyqësore për të siguruar dokumente që, sipas ligjit, duhet të jenë të aksesueshme menjëherë.

Kjo situatë tregon hendekun e madh mes vlerësimit normativ të ligjit shqiptar, i cili është cilësuar si "i gjashti më i mirë në botë", dhe praktikës së përditshme. Nëse 2% e rasteve që shkojnë në gjykatë janë pikërisht ato që kanë rëndësi jetike për transparencën dhe llogaridhënien, atëherë ky 2% nuk është statistikë e vogël, por një dështim substancial i sistemit. Shqipëria, në këtë aspekt, mbetet larg standardeve që përfaqëson renditja formale në RTI Rating.

V. KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Ligji nr.119/2024 “Për të drejtën e informimit”, ngarkon Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si institucionin përgjegjës për monitorimin e zbatimit të ligjit.

Kompetencat e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, janë rritur me ndryshimet ligjore të vitit 2023, në favor të fuqizimit të rolit të Komisionerit. Me ligjin e ri Komisioneri vendos më shumë masa administrative se më parë, në rast të moszbatimit të ligjit.

Komisioneri ka për detyrë të monitorojë zbatimin e ligjit dhe këtë ai e bën në dy plane; nëpërmjet: (1) monitorimit të institucioneve në plotësimin dhe përditësimin e programeve të transparencës; caktimin e koordinatorit për të drejtën e informimit; publikimin dhe përditësimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve si dhe; (2) në zgjidhjen e ankesave të adresuara në rastet e refuzimit të dhënies së informacionit nga ana e autoriteteve publike.

Sa i takon trajtimin të ankesave, Res Publica ka monitoruar veprimtarinë e Komisionerit lidhur me zbatueshmërinë e ligjit, që prej momentit të krijimit të tij në vitin 2014.

Të dhënat e përdorura për vlerësimin e veprimtarisë së kësaj zyre, janë siguruar nga informacioni zyrtar i marrë nga zyra e Komisionerit si dhe monitorimi i të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të tij.

Në këtë raport, do të pasqyrohen në mënyrë të përmblodhur të dhënat për 10 vite në lidhje me numrin e ankesave drejtuar Komisionerit, kategorinë e subjekteve që kanë bërë ankesat, numrin e vendimeve, llojet e vendimeve, kohëzgjatjen e marrjes së vendimeve, aplikimin e sanksioneve.

5.1 Rezoluta e Kuvendit e vitit 2023


Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si çdo vit, edhe për vitin 2023 ka paraqitur raportin vjetor në Kuvend. Procesi është finalizuar me miratimin e Rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit për vitin 2023. Në këtë dokument, Kuvendi ka vlerësuar arritjet dhe punën e Komisionerit, por ka përcaktuar edhe një sërë rekomandimesh për vitin 2024. Vetë Komisioneri, në raportin e fundit, konfirmon se këto rekomandime janë zbatuar në mënyrë të plotë. Kjo pasqyron një raportim formal dhe një angazhim të drejtpërdrejtë të institucionit për të përmbushur pritshmëritë e Kuvendit, megjithëse në praktikë mbetet për t'u vlerësuar shkalla reale e ndikimit të këtyre masave.

Rekomandimet që Kuvendi ka lënë për vitin 2024 kanë pasur në fokus pikërisht rritjen e transparencës dhe forcimin e mekanizmave mbikëqyrës në këtë fushë. Tre shtyllat kryesore kanë qenë:

- Mbikëqyrja dhe monitorimi i transparencës proaktive. Institucionet publike duhet të publikojnë rregullisht programet e transparencës dhe regjistrat e kërkesave e përgjigjeve. Këto programe duhet të përditësohen vazhdimisht, duke garantuar që informacioni të jetë jo vetëm i plotë, por edhe i freskët dhe i përdorshëm për qytetarët.
- Rritja e llogaridhënies së administratës publike. Kuvendi ka kërkuar që Komisioneri të vendosë theksin te detyrimi i institucioneve për të qenë më të përgjegjshme dhe llogaridhënese përballë qytetarëve. Kjo është menduar të realizohet përmes forcimit të mekanizmave elektronikë të raportimit, transparencës online dhe vlerësimit të performancës së autoriteteve.
- Asistencë për autoritetet publike. Një pjesë e rekomandimeve kanë pasur si qëllim lehtësimin e zbatimit të ligjit nga vetë institucionet publike. Komisioneri është ngarkuar të ofrojë udhëzime, trajnime dhe asistencë praktike, me qëllim rritjen e kapaciteteve institucionale për të përmbushur detyrimet ligjore për transparencë. Në këtë kuadër, është theksuar edhe roli i portaleve elektronike si pyetshteti.al, të cilat duhet të funksionojnë si mekanizma të drejtpërdrejtë dhe të thjeshtë për qytetarët.

Konstatohet se Rezoluta e vitit 2024, për vitin 2023 nuk ka marrë në konsideratë asnjë raport apo gjetje të organizatave të shoqërisë civile dhe të medias, duke paraqitur një rezolutë të cunguar që nuk pasqyron realisht problematikën me të cilat përballen qytetarët dhe gazetarët në ushtrimin e të drejtës për informim.

5.2 Numri i ankesave drejtuar Komisionerit



Për vitin 2024, numri i ankesave të paraqitura pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit ka mbetur në të njëjtin nivel me katër vitet e fundit, me vetëm diferenca të papërfillshme nga viti në vit. Ky stabilitet relativ tregon se mekanizmi i ankimit është tashmë i konsoliduar si një rrugë e përdorur gjerësisht nga qytetarët, gazetarët dhe organizatat e shoqërisë civile sa herë që institucionet publike refuzojnë të japin informacion.

Nëse e shohim panoramën në një hark kohor prej dhjetë vitesh, vërehet se:

- 2015–2016: Ankesat ishin ende në një nivel më të ulët, për shkak të mungesës së njohjes së ligjit dhe të mekanizmit të ri të Komisionerit.
- 2017–2020: Numri i ankesave u rrit në mënyrë progresive, duke reflektuar si rritjen e ndërgjegjësimit të publikut, ashtu edhe refuzimet e shumta të institucioneve për të dhënë informacion.
- 2021–2022: Shënohet kulmi i ankesave, me mbi 1000 raste në vit, çka përbën nivelin më të lartë të dekadës. Ky fenomen u lidh ngushtë me rritjen e kërkesave nga gazetarët investigativë dhe organizatat e shoqërisë civile, veçanërisht për informacion mbi kontratat publike, prokurimet dhe proceset e rindërtimit pas tërmetit.
- 2023–2024: Ankesat vijojnë të mbeten shumë të larta (në të njëjtin nivel me vitin 2022), duke treguar se problemet strukturore në dhënien e informacionit nuk janë adresuar.


Fakti që numri i ankesave mbetet i lartë në mënyrë të qëndrueshme për më shumë se gjysmën e dekadës tregon se:

1. Institucionet publike vijojnë të kenë një kulturë rezistence ndaj dhënies së informacionit, veçanërisht për temat me interes publik të lartë.
2. Mekanizmi i ankimit funksionon si një filtër i domosdoshëm, duke u kthyer në hapin e dytë të zakonshëm për marrjen e informacionit.
3. Ndërgjegjësimi i qytetarëve dhe gazetarëve është rritur, pasi numri i lartë i ankesave

tregon përdorim aktiv të të drejtës për informim, edhe kur rruga është e gjatë dhe e vështirë.

Gjatë periudhës 2015–2024 kemi një rritje të qëndrueshme dhe më pas stabilizim të ankesave në një nivel shumë të lartë. Ky fakt është ambivalent sepse nga njëra anë është tregues i një publiku aktiv dhe i një ligji që ofron mjete të ankimi dhe nga ana tjetër është provë e qartë se institucionet publike nuk kanë ndryshuar sjelljen në mënyrë progresive dhe se transparenca reaktive vazhdon të mbetet problem serioz.

5.3 Subjektet që i janë drejtuar Komisionerit




Nga 939 ankesa të adresuara pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale gjatë vitit 2024, vihet re kjo shpërndarje:

- 58% e ankesave janë paraqitur nga gazetarë dhe aktivistë të shoqërisë civile;
- 42% e ankesave janë paraqitur nga qytetarë të zakonshëm.

Ky raport dëshmon se kategoria e gazetarëve dhe aktivistëve vijon të jetë më e angazhuara në përdorimin e instrumentit të ankimit, duke qenë më të ndërgjegjësuar për të drejtat e tyre ligjore dhe më këmbëngulës për të siguruar informacionin e refuzuar nga autoritetet publike.

Të dhënat e viteve të fundit tregojnë qartë se gazetarët dhe aktivistët mbeten kategoria kryesore që i drejtohen Komisionerit. Në periudhën 2020–2024 ata kanë përbërë gjithmonë mbi gjysmën e ankimesve, shpesh në nivelin 55–65%. Kjo lidhet me natyrën e informacionit që kërkojnë, shpesh mbi kontrata koncesionare, prokurime publike, të dhëna mbi rindërtimin ose sektorë të tjerë me ndikim të madh publik, që janë edhe më të ndjeshëm dhe, rrjedhimisht, më të refuzuar nga institucionet.

5.4 Numri i vendimeve të marra nga Komisioneri



Referuar të dhënave zyrtare të publikuara nga Komisioneri dhe monitorimit të kryer nga Res Publica, për vitin 2024 janë marrë vetëm 22 vendime. Ky është numri më i ulët i pesë viteve të fundit, duke përbërë një tregues shqetësues për funksionalitetin e mekanizmit të ankimit.

Kjo shifër bëhet edhe më problematike nëse vendoset në raport me numrin e lartë të ankesave të paraqitura (939 gjatë vitit 2024). Kjo do të thotë se vetëm një pjesë shumë e vogël e tyre (më pak se 3%) është finalizuar me një vendim formal të Komisionerit, ndërsa pjesa tjetër ose është zgjidhur përmes komunikimeve joformale, ose ka mbetur pa trajtuar në mënyrë të plotë.


Ecuria e luhatshme e vendimmarrjes së Komisionerit tregon se nuk ka një trend progresiv në rritjen e vendimmarrjes, përkundrazi vihet re një paqëndrueshmëri që varet më shumë nga rrethanat e vitit (numri i ankesave, tematika e tyre, apo dinamika institucionale) sesa nga një praktikë e konsoliduar funksionimi.

Mungesa e vendimeve është një nga pikat më kritike në veprimtarinë e Komisionerit:

- Së pari, ajo dobëson besueshmërinë e institucionit, pasi qytetarët dhe gazetarët presin një reagim formal dhe të detyrueshëm, jo një ndërmjetësim joformal.
- Së dyti, pa vendime të qarta nuk krijohet jurisprudenca administrative, e cila është e domosdoshme për të orientuar institucionet publike dhe gjykatat mbi standardet e transparencës.
- Së treti, mungesa e vendimeve nënkupton edhe mungesë sanksionesh, pasi gjobat zakonisht lidhen me trajtimin përfundimtar të një anekese.

Numri i ulët i vendimeve në vitin 2024 nxjerr në pah një problem të përsëritur gjatë gjithë dekadës, që ankesat rriten por vendimmarrja mbetet e kufizuar. Pa një reformim të mënyrës

së funksionimit, ku Komisioneri të detyrohet të shprehet me vendim për çdo ankesë, ekziston rreziku që ky mekanizëm të shihet më shumë si një hap formal sesa si një garanci e vërtetë për të drejtën e informimit.



Sipas nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Komisioneri ka kompetencën të vendosë:

- mospranimin e ankesës,
- pranimin e plotë ose të pjesshëm të saj dhe urdhërimin e autoritetit publik për dhënien e informacionit,
- ose rrëzimin e ankesës, tërësisht ose pjesërisht.

Në rast pranimi, Komisioneri ka gjithashtu të drejtë të vendosë sanksione administrative ndaj titullarëve të autoriteteve publike, kur konstaton shkelje të ligjit.

Nga analiza e vendimeve të publikuara dhe të dhënave të siguruara nga zyra e Komisionerit, për vitin 2024:

- 64% e vendimeve ishin pranime të plota të ankesave;
- 4% e vendimeve ishin pranime të pjesshme;
- 32% e vendimeve ishin rrëzime ose mospranime.

Ky rezultat përbën një ndryshim të ndjeshëm krahasuar me vitet e mëparshme. Përqindja e rrëzimeve në 2024 është më e larta e regjistruar që prej vitit 2015.

Në vitet e para të zbatimit të ligjit të ri (2015–2018), pjesa dërrmuese e vendimeve ishin pranuese, shpesh mbi 80–90%.


Nga viti 2019 e në vijim, ndonëse pranimet mbetën dominante, u shënua një rritje graduale e vendimeve të rrëzimit, duke reflektuar ose një qasje më kritike të Komisionerit ndaj ankesave, ose një formulim më i dobët i disa ankesave nga qytetarët dhe gazetarët.

Viti 2024 shënon pikun e këtij trendi, me 1/3 e vendimeve në favor të institucioneve.

Një nga aspektet më të ndjeshme mbetet ekzekutimi i vendimeve. Edhe kur Komisioneri pranon ankesën dhe urdhëron dhënien e informacionit, nuk ka garanci të plotë që vendimi do të zbatohet. Për vitin 2024, referuar përgjigjes zyrtare të Komisionerit, është shënuar vetëm një rast kur u vendos gjobë për moszbatim vendimi. Ky është një tregues i qartë se mosrespektimi i vendimeve vijon të jetë i përhapur, ndërsa përdorimi i sanksioneve administrative mbetet i rrallë.

Sipas ligjit, moszbatimi i vendimeve të Komisionerit është kundërvajtje administrative dhe ndëshkohet me gjobë që varion nga 150 000 deri në 300 000 lekë. Megjithatë, aplikimi sporadik i këtij mekanizmi bën që shumë institucione të ndjehen ende të pandëshkueshme.

5.5 Kohëzgjatja e marrjes së vendimeve nga Komisioneri



Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” parashikon se Komisioneri ka detyrimin të marrë një vendim brenda 15 ditëve pune nga marrja e ankimit. Ky afat është maksimal, që do të thotë se vendimmarrja duhet të kryhet brenda kësaj kohe, në mënyrë që qytetarët ose gazetarët të mos mbeten të penguar në ushtrimin e të drejtës së tyre.

Nga analiza e të dhënave për vitin 2024 rezulton se Komisioneri ka marrë vendim brenda afatit ligjor në 36% të rasteve, ndërsa pjesa tjetër e vendimeve është dhënë jashtë afatit. Edhe pse shifra mbetet e ulët, duhet theksuar se ka një përmirësim të dukshëm krahasuar me vitin 2023, kur vetëm 4% e vendimeve ishin brenda afatit ligjor. Kjo sugjeron një angazhim më të madh të Komisionerit për të respektuar afatet, por niveli i përgjithshëm ende nuk është i kënaqshëm.

Në një perspektivë 10 vjeçare, panorama është e paqëndrueshme:

- 2017–2018: respektimi i afatit ligjor ishte shumë i ulët, duke reflektuar fazën e hershme të funksionimit të institucionit.

- 2019–2020 u shënua një përmirësim gradual, me kulmin në 2019, ku 77% e vendimeve u morën brenda afatit ligjor, shifra më e lartë e dekadës.
- 2021–2023: trendi u përkeqësua ndjeshëm, duke rënë në nivelet më të ulëta 48% në 2023).
- 2024: shënon një rikthim modest në respektimin e afatit, me 36% të vendimeve brenda 15 ditëve.

Kjo luhatje tregon qartë se nuk ekziston një praktikë e konsoliduar për respektimin e afateve ligjore, dhe performanca ndryshon nga viti në vit.

Një element që shpjegon pjesërisht tejkalimin e afatit është praktika e Komisionerit për të zhvilluar seanca dëgjimore me palët përpara dhënies së vendimit. Për vitin 2024, janë evidentuar 9 raste të tilla, të cilat natyrisht kanë zgjatur procesin, por synojnë të rrisin cilësinë e vendimarrjes. Megjithatë, ky justifikim nuk mund të përdoret për shumicën e rasteve, ku vonesat lidhen më tepër me kapacitete të kufizuara apo me mungesë vullneti për të vendosur me kohë.

5.6 Aplikimi i sanksioneve

Aplikimi i sanksioneve nga Komisioneri

2015											2
2016											2
2017											6
2018											4
2019											5
2020											0
2021											8
2022											3
2023											1
2024											4

Gjatë vitit 2024, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka vendosur gjithsej 4 gjoba ndaj autoriteteve publike për shkelje të ligjit nr. 119/2014. Shkeljet kanë të bëjnë kryesisht me moszbatim të programeve të transparencës dhe mosrespektim të vendimeve të Komisionerit për dhënien e informacionit.

Kjo shifër, edhe pse në dukje e ulët, përfaqëson një rritje relative në raport me numrin e përgjithshëm të vendimeve të marra, i cili në vitin 2024 ka qenë një nga më të ulët të dekadës (vetëm 22 vendime). Kështu, raporti mes vendimeve të dhëna dhe atyre të shoqëruara me gjobë është më i lartë se në vitet e mëparshme.

Edhe pse të dhënat tregojnë një rritje relative të përdorimit të sanksioneve krahasuar me vendimarrjen totale, problemi mbetet se numri absolut i gjobave është i papërfillshëm

përballë mijëra ankesave të trajtuara ndër vite. Ky nivel i ulët ndëshkimesh krijon perceptimin se shkelja e ligjit nuk ka pasoja reale për institucionet, duke inkurajuar vazhdimin e sjelljes rezistuese ndaj kërkesave për informacion.

Nga ana tjetër, fakti që gjobat janë vendosur kryesisht për çështje të transparencës proaktive (programe, regjistra, publikime online) dhe shumë më pak për refuzimet e drejtpërdrejta të informacionit, tregon një orientim selektiv të Komisionerit. Transparenca proaktive është padyshim thelbësore, por shkeljet më të rënda, si mospërgjigja ose refuzimi i kërkesave me interes të lartë publik, shpesh kalojnë pa ndëshkim.

Viti 2024 konfirmon tendencën e viteve të fundit që sanksionet ekzistojnë, por mbeten të rralla. Raporti më i lartë mes gjobave dhe vendimeve është një sinjal pozitiv, por jo i mjaftueshëm për të krijuar efekt parandalues. Për të pasur një ndikim real, Komisioneri duhet:

- të zbatojë gjoba në mënyrë sistematike ndaj çdo rasti të shkeljes së ligjit,
- të trajtojë me prioritet mospërgjigjet e përsëritura dhe refuzimet arbitrare,
- të publikojë në mënyrë transparente listën e institucioneve të ndëshkuara, për të forcuar presionin publik dhe reputacional mbi administratën.


VI. TË DHËNA NGA PLATFORMA PUBLEAKS.AL

Që prej vitin 2016, platforma publeaks.al vijon ti shërbejë çdo qytetari, gazetari, studiuesi, aktivisti të shoqërisë civile, etj që dëshiron të marrë informacione nga institucione të ndryshme pa qenë nevoja që të humbasin energji dhe kohë për kërkimin dhe ndjekjen e procedurave të kërimit të informacionit. Përgjatë gjith kohës së funksionimit të saj, nëpërmjet kësaj platforme janë kërkuar informacione të fushave të ndryshme si mjedis, ekonomi, prokurime, buxhet, shëndetësi etj, duke regjistruar mbi 2500 kërkesa për informacion, të trajtuara ku informacioni i marrë është i hapur për publikun.

Publeaks.al përdoret nga kategori të ndryshme individësh, të cilët kërkojnë informacione të larmishme, ku një pjesë e tyre mund ti përdorë për realizimin e punës së tyre, një pjesë e mirë gazetari. Më poshtë gjenden të dhënat mbi përdorimin e kësaj platforme për vitin 2024 lidhur me:

- përdorimi i Publeaks.al
- objekti i informacionit të kërkuar
- autoritetet publike të cilëve u drejtohet kërkesa
- arsimi i aplikuesve
- mosha e aplikuesve
- gjinia e aplikuesve

6.1. Përdorimi i faqes Publeaks.al



Nga të dhënat e raportuara për vitin 2024, vihet re një përdorim i shpërndarë gjatë gjithë vitit, me disa muaj më aktivë, si muaji Mars që shënoi kulmin e vizitave (2300), çka lidhet me publikimin e disa raportimeve të rëndësishme të mediave investigative dhe interesin e shtuar publik në prag të sesioneve parlamentare pranverore. Muaji me më pak vizita rezultoi gushti (1100), periudhë kur trafiku bie zakonisht për shkak të pushimeve verore dhe mungesës së aktiviteteve institucionale.


80% e trafikut vjen nga Shqipëria, me qendra kryesore si Tirana, Shkodra, Durrësi, Berati, Fieri dhe Korça.

Të dhënat tregojnë se Publeaks.al është konsoliduar si një mjet i qëndrueshëm për kërkesat për informacion, me një audiencë të posaçme që reflekton nevojën reale të një pjese të specializuar të publikut për të kërkuar transparencë nga institucionet.

a) Aplikantët sipas grupmoshave

Publeaks.al është konceptuar si një platformë e thjeshtë dhe e aksesueshme për këdo, pavarësisht moshës apo nivelit të njohurive teknologjike. Ajo ofron mundësinë që çdo individ, nga studentët te pensionistët, të parashetrojnë kërkesat e tyre për informacion pranë autoriteteve publike pa pasur nevojë të njohin procedurat e ndërlikuara ligjore.

**Aplikantët e Publeaks.al
sipas grupmoshës (%)**




Sipas statistikave të grumbulluara për vitin 2024, aplikantët e Publeaks.al janë të shpërndarë në disa grupmosha ku ajo 30–40 vjeç përbën pjesën më të konsiderueshme të përdoruesve, kryesisht studentë, gazetarë të rinj dhe aktivistë të shoqërisë civile. Megjithatë edhe mosha të tjera shprehin interes të qëndrueshëm.

Në dhjetë vitet e monitorimit të përdorimit të platformës, vihet re se moshat 20–40 vjeç mbeten gjithmonë më aktive, ndërsa grupmoshat mbi 40 vjeç kanë luhatje të lehta në varësi të kontekstit social dhe politik. Megjithatë, të dhënat nuk tregojnë një trend të qëndrueshëm rritës apo ulës për ndonjë grup të caktuar. Përkundrazi, përdorimi është shpërndarë në mënyrë të qëndrueshme mes grupmoshave, duke treguar se platforma ka fituar një besueshmëri te disa breza.

b) Aplikantët sipas arsimit

**Aplikantët e Publeaks.al
sipas nivelit të arsimit (%)**



Analiza e përdorimit të platformës Publeaks.al sipas nivelit arsimor tregon se kategoria më aktive mbetet ajo me arsim të lartë Master. Kjo prirje është e pritshme, pasi individët me këtë nivel arsimor shpesh janë të përfshirë në punë kërkimore, projekte akademike, organizata joqeveritare apo media, ku nevoja për informacion publik është më e theksuar.


Pas tyre, pjesën më të madhe e zënë përdoruesit me nivel Bachelor, të cilët janë kryesisht studentë ose profesionistë të rinj, që kërkojnë informacion për qëllime studimore, gazetareske ose për të testuar transparencën institucionale. Kjo kategori e përdor platformën si një mjet praktik për të siguruar të dhëna zyrtare që shpesh mungojnë në faqet e institucioneve.

Më pak aktive janë grupet me arsim të mesëm dhe arsim 9-vjeçar, megjithëse ato nuk mungojnë plotësisht. Kërkesat e tyre lidhen shpesh me nevoja praktike dhe personale, si çështjet e pronësisë, të drejtave sociale ose procedurat administrative. Përqindja e ulët tregon se ndërgjegjësimi për përdorimin e ligjit për të drejtën e informimit mbetet më i lartë te qytetarët me arsim më të avancuar.

Në dhjetë vitet e fundit të monitorimit, vihet re një vijimësi e prirjes që kategoritë me arsim të lartë të dominojnë përdorimin e Publeaks.al. Në fillim, kjo shpjegohej si pasojë e mungesës së njohjes së platformës nga qytetarët e zakonshëm. Por edhe me rritjen e ndërgjegjësimit publik, profili i përdoruesve ka mbetur pothuaj i njëjtë. Më aktivë janë studentët universitarë, gazetarët dhe ekspertët e shoqërisë civile. Ky fenomen dëshmon se Publeaks.al shihet më tepër si një instrument profesional, sesa si një mjet për kërkesa të përditshme nga qytetarët e zakonshëm.

Këto të dhëna tregojnë se niveli arsimor lidhet drejtpërdrejt me përdorimin e të drejtës për informim. Sa më i lartë niveli i arsimit, aq më i madh është interesimi për të shfrytëzuar instrumente ligjore si Publeaks.al. Nga njëra anë, kjo është pozitive, pasi platforma u shërben atyre që e përdorin për të ndërtuar dije, për të monitoruar qeverisjen ose për të prodhuar gazetari investigativ. Nga ana tjetër, mbetet sfida e hapur nxitja e përdorimit edhe nga qytetarët me arsim më të ulët, për të cilët aksesit në informacion është po aq i rëndësishëm për ushtrimin e të drejtave të tyre.

d) Aplikantët/et sipas gjinisë



Nga të dhënat e mbledhura për vitin 2024, rezulton se meshkujt kanë qenë pak më aktivë në përdorimin e platformës Publeaks.al për të kërkuar informacion. Megjithatë, diferenca me aplikantët femra nuk është e madhe, duke dëshmuar se platforma përdoret gjerësisht nga të dyja gjinitë.

Në dekadën e parë të funksionimit të Publeaks.al, të dhënat kanë treguar vazhdimisht një balancë relative mes gjinive, pa ndonjë dominim të qartë dhe të qëndrueshëm. Në disa vite, aplikantët femra kanë qenë më të pranishme, veçanërisht në periudhat kur temat e kërkesave kanë qenë të lidhura me shërbimet publike, çështjet sociale ose mjedisin; ndërsa në vitet e tjera, si 2024, aplikantët meshkuj rezultojnë disi më të shumtë, kryesisht për kërkesa që lidhen me sektorë si prokurimet publike, energjia apo ndërtimi.

Ky balancim i ngushtë ndër vite tregon se Publeaks.al është një platformë e përvetësuar nga të dy gjinitë. Në aspektin shoqëror, kjo është një arritje e rëndësishme, pasi në shumë fusha pjesëmarrja e grave në ushtrimin e të drejtave ligjore është më e ulët. Platforma ka thjeshtuar aq shumë procedurën e kërkesave për informacion, saqë nuk krijon barrierë gjinore apo sociale.

VII. RASTE PRAKTIKE

TË VITIT 2024

Në rastet e refuzimit të dhënies së informacionit nga organi publik, mekanizmi ligjor për ta siguruar atë është nëpërmjet ankimit. Si fillim, kërkuesi i informacionit bën një ankim administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe nëse përsëri nuk e siguron dot informacionin e adreson çështjen në gjykatë.

Me ligjin 78/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” në nenin 24 të ligjit u shtua dhe parashikimi si më poshtë:

“6/1. Autoriteti publik është i detyruar të zbatojë vendimin e Komisionerit kur ka urdhëruar dhënien e informacionit të kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme, me përjashtim të rastit kur gjykata vendos pezullimin e zbatimit të tij”

Por sa të ndërgjegjshme janë autoritetet publike për të zbatuar vendimin e dhënë nga Komisioneri?

Në rastet praktike të ndjekura nga ResPublica për vitin 2024 ka rezultuar se autoritetet nuk ka vullnetin për dhënien e informacioneve të kërkuara pavarësisht nëse ka një vendim të Komisionerit për detyrimin e tyre.

Gazetarja L.Ç. kundër Gjykatës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

Rasti në fjalë i referohet kërkimit të informacionit nga gazetarja L.C pranë Gjykatës së Posaçme. Gjendur në kushtet e refuzimit të dhënies së informacionit, gazetarja iu drejtua Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili vendosi në favor të gazetares dhe detyrimin e autoritetit publik për të vënë në dispozicion informacionin e kërkuar. Duke mos qenë dakord me këtë vendim, autoriteti publik iu drejtua Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për shfuqëzimin e këtij vendimi. Gjykata Administrative rrëzoi padinë duke lënë në fuqi vendimin e Komisionerit që detyron autoritetin publik. Duhet thënë që ky ishte një rast suksesi pasi edhe vetë autoriteti publik nuk ankimoi vendimin e gjykatës por i vuri në dispozicion dokumentacionin gazetares, e cila në procesin gjyqësor u përfaqësua nga ResPublica.

Res Publica kundër Kryeministritë

Në datën 16.12.2022, Qendra "Res Publica", ka dërguar kërkesën për informacion duke kërkuar nga autoriteti publik, Kryeministritë: Kopje të relacionit shoqërues të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave Nr.3, datë 28.12.2016 "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016". Pas refuzimit të dhënies së informacionit me argumentin se relacionet janë të dhëna konfidenciale, ResPublica i është drejtuar Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nga i cili nuk u mor asnjë vendimarrje lidhur me ankesën e paraqitur. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin Nr. 1108 datë 15.04.2024 ka vendosur detyrimin e Kryeministritë të japë informacionin që konsiston në kopje të relacionit shoqërues të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2026" duke argumentuar se sipas nenit 17 të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2023 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", relacionet nuk konsiderohen si akte konfidenciale, dhe refuzimi i dhënies së tyre është i pabazuar në ligj dhe në fakte.

Vlen për tu përmendur fakti, se nga ana e ResPublicës është kërkuar vazhdimisht kopje të relacioneve të Vendimeve të Këshillit të Ministrave, dhe në asnjë rast Kryeministria nuk ka dhënë informacionin e kërkuar pavarësisht se mund të ketë patur një vendim Komisioneri që e detyron për të dhënë informacionin apo dhe vendim Gjykate.

Në çështjet që vetë ResPublica ka patur apo çështjet që ka përfaqësuar përgjatë këtyre 10 viteve nga hyrja në fuqi e ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit" duhet thënë se jo gjithmonë autoriteti publik ka patur vullnetin e dhënies së informacionit qoftë edhe kur ndaj tij ka patur një vendim të Komisionerit për të drejtën e informimit. Ngarkesa e gjyqësorit nga ana tjetër, ka ndikuar në vonesën e trajtimit të çështjeve të adresuara në Gjykatë. Gjatë vitit 2024, janë zhvilluar në Gjykatën e Apelit çështje të së drejtës së informimit të adresuara nga ResPublica dhe çështje të gazetarëve të përfaqësuar prej saj.

Res Publica kundër Ministrisë së Mbrojtjes¹

Rasti në fjalë i referohet çështjes së iniciuar nga ResPublica në vitin 2015 e cila kërkoi informacion pranë Ministrisë së Mbrojtjes në lidhje me "...Kopje të studimit Vlerësimi paraprak i riskut mjedisor të eksplozivëve në Fambrikën Mjekës në Shqipëri". Pas refuzimit të dhënies së informacionit nga ana e Ministrisë me arsyetimin se informacioni kufizohet për shkak të të drejtave të autorit, ResPublica iu drejtua me ankesë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili me vendimin Nr. 01 datë 25.01.2016 vendosi pranimin e ankesës dhe detyrimin e autoritetit publik për të vënë në dispozicion dokumentacionin. Duke u gjendur përballë faktit të mosekzekutimit të këtij vendimi, ResPublica iu drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duke kërkuar zbatimin e vendimit të Komisionerit. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka pranuar padinë e ResPublica, duke afirmuar se informacioni i kërkuar është informacion publik dhe si i tillë duhet ti jepet kërkuarit, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Administrativ në vitin 2024.

¹ Aktualisht çështja ndodhet në Gjykatë të Lartë për shkak të ushtrimit të rekursit nga Avokati i Shteti pranë Ministrisë së Mbrojtjes

Gazetari A.R. kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhenave Personale Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve

Çështja është iniciuar në vitin 2017, ku gazetari A.R ka kërkuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dokumentacionin për shlyerjen e detyrimeve tatimore të shoqërisë “EDIL-AL-IT”. Pas refuzimit të dhënies së informacionit, gazetari i është drejtuar Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhenave Personale. Në lidhje me këtë ankesë, Komisioneri nuk ka dalë me një vendim sipas ligjit “Për të drejtën e informimit”, por është bërë me dije nëpërmjet një shkresë të Drejtorisë për të Drejtën e Informimit pranë Komisionerit e cila bën me dije se ankesa nuk mund të shqyrtohet për shkak se informacioni i kërkuar është i kufizuar pasi përbën sekret tregtar. Pas adresimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, kjo e fundit disponoi me vendim pranimi duke konsideruar informacionin e kërkuar si informacion publik dhe duke detyruar Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për të vënë në dispozicion informacionin e kërkuar. Më datë 04.04.2024, Gjykata Administrative e Apelit ka lënë në fuqi vendimin e Shkallës së Parë duke ri afirmuar se informacioni i kërkuar nga gazetari është publik dhe duhet të vihet në dispozicion.

Gazetari A.R kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhenave Personale Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve

Më datë 18.01.2017 gazetari A.R ka kërkuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve informacion në lidhje me listën e punonjësve që punojnë në media (Klan, Vision Plus, Top Channel, Ora News, Report Tv). Pas refuzimit të informacionit, gazetari i është drejtuar me ankesë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhenave Personale. Edhe në këtë rast gazetari i është kthyer një përgjigje nga Drejtoria për të Drejtën e Informimit pranë Komisionerit (jo vendim siç parashikon ligji) ku i është komunikuar se informacioni i kërkuar janë të dhëna personale. Duke mos qenë dakord me këtë vendimarrje gazetari i është drejtuar Gjykatës. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin e datës 03.05.2017 vendosi pranimin e padisë duke detyruar autoritetin publik për të vënë në dispozicion dokumentacionin. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit më datë 19.06.2024.

Në të dyja rastet e mësipërme, si Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ashtu edhe e Apelit përveç detyrimit të autoritetit publik për të vënë në dispozicion dokumentacionin kanë konstatuar edhe pavlefshmërinë absolute të shkresave të Drejtorisë për të Drejtën e Informimit pranë Komisionerit duke afirmuar se vendimarrja në lidhje me ankesat që paraqiten tek Komisioneri është kompetencë ekskluzive e Komisionerit dhe shkresat e lëshuara nga Drejtoria janë në tejkalim të kompetencave dhe në kundërshtim me ligjin.

Raste negative

Përveç rasteve të mësipërme, të cilat në njëfarë mënyre kanë rezultuar të suksesshme sa i takon vendimarrjes nga ana e Gjykatës, për 2024 ka patur dhe raste negative të cilat ndikojnë pengimin e dhënies së informacionit.

ResPublica kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Më datë 14.02.2023, Qendra "Res Publica" ka kërkuar pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale informacionin në lidhje me: Cilat janë masat e marra nga Ministria e Shëndetësisë lidhur me rekomandimet e dhëna nga Avokati i Popullit me datë 21.05.2014? A është miratuar një protokoll për trajtimin e pacientëve me "Hipertermi Malinje", gjatë ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor? Nëse po, ju lutemi na vini në dispozicion një kopje të protokollit të miratuar. Në mungesë të një përgjigjeje, Qendra ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale i cili disponoi me vendim pranë duke urdhëruar Ministrinë për të vënë në dispozicion informacionin e kërkuar. Gjendur përballë faktit të moszbatimit të këtij vendimi, Res Publica i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për detyrimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit dhe dhënien e informacionit. Gjykata nga ana tjetër shprehet *"...pala paditëse ka shteruar rrugën administrative dhe organi publik Komisioneri për të Drejtën e informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është shprehur duke pranuar kërkesën e saj me të cilën paditësi është plotësisht dakord, ndaj subjekti s'ka të drejtë t'i drejtohet më gjykatës me padi përse kohë që ky kërkim është zgjidhur në rrugë administrative. Rrjedhimisht gjykata çmon se kjo është një padi që nuk kjo padi nuk mund të ngrihet nga pala paditëse, pasi Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka të gjithë mekanizmat ligjor për të detyruar organin publik të zbatojë një vendimarrje të tij përfundimtare përveçse nëse ky vendim është ankimmuar nga organi publik në rrugë gjyqësore. Megjithatë edhe në këtë rast ky konflikt do të zgjidhej përfundimisht në procesin gjyqësor ku kundërshtohet Vendimi i Komisionerit për të Drejtën e Informimit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe jo të ngrihet padi më vete me këtë objekt e shkak ligjor..."*

Kjo qasje e gjykatës për të vlerësuar vendimin e Komisionerit si zgjidhje përfundimtare të së drejtës së cënuar çon edhe në vetë cënimin e të drejtës duke mos dhënë një zgjidhje në rastet kur një vendim i Komisionerit nuk zbatohet nga ana e autoritetit publik.

ResPublica kundër Ministrisë së Drejtësisë

Çështja në fjalë është rast i kthyer për gjykim nga Gjykata e Lartë. Në vitin 2013 Respublica ka kërkuar informacion (sipas ligjit të kohës 1999) pranë Ministrisë së Drejtësisë për tu informuar nëse ka patur kërkesa kërkesa për procedim penal, ekstradim, transferim dosjesh apo vendime gjyqësore penale etj, në shtetet e tjera, për disa nga kandidatët që konkuronin në atë kohë si deputetë të Kuvendit të Shqipërisë. Pas refuzimit të dhënies së informacionit nga Ministria dhe ndjekja në të tre shkallët e Gjyimit, çështja u rikthye për rigjykim në Gjykatë Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin Nr. 3406 datë 03.10.2024 rrëzon padinë e ResPublica me arsyetimin se ka mungesë të interesit të ngritjes së padisë nga paditësi dhe se kërkitimi nuk i përgjigjet aktualitetit duke krijuar në këtë mënyrë një normë të re juridike për kufizimin e dhënies së informacionit dhe një precedent të rrezikshëm e cila mund të aplikohet nga autoritetet publike për të refuzuar dhënien e informacioneve.

Kostoja e aksesit në informacion dhe rasti i Bashkisë Tepelenë

Ligji për të drejtën e informimit, në nenin 13, përcakton qartë se si rregull informacioni duhet të jepet pa pagesë. Në rastet kur aplikohen tarifa, ato kufizohen vetëm në koston reale të riprodhimit dhe, nëse është e nevojshme, të dërgimit të dokumenteve. Për më tepër, ligji thekson se çdo informacion i kërkuar në mënyrë elektronike duhet të jepet falas, ndërsa tarifatat duhet të jenë të shpallura publikisht nga autoritetet. Kjo qasje synon të balancojë të

drejtën për informim me shpenzimet e mundshme administrative, pa e penguar qytetarin të ushtrojë një të drejtë kushtetuese.

Megjithatë, praktika ka treguar se disa institucione publike në Shqipëri e kanë interpretuar këtë dispozitë në mënyrë abuzive. Një shembull tipik është ai i Bashkisë Tepelenë, ku Qendra Res Publica paraqiti një kërkesë për informacion lidhur me projektin e ndërtimit të rrjetit të furnizimit me ujë në disa fshatra dhe kontratën përkatëse me subjektet private që zbatonin punimet. Në përgjigjen e saj, Bashkia njoftoi se dokumentacioni mund të vihej në dispozicion vetëm pas pagesës së një tarife prej 231,500 lekësh, duke bashkëngjitur edhe një faturë tatimore.

Res Publica e konsideroi këtë shumë si të pajustificuar dhe abuzive, pasi nuk reflektonte aspak koston reale të riprodhimit të dokumenteve. Për këtë arsye, u paraqit një ankim administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit. Pas ndërhyrjes së Komisionerit, Bashkia Tepelenë u detyrua të vërë në dispozicion linkun ku ishte publikuar informacioni, por ndërkohë vijoi ta konsideronte shumën e kërkuar si një detyrim financiar ndaj Qendrës Res Publica. Madje, në vijim, Bashkia refuzoi t'i përgjigjej një kërkesë të re për informacion, me argumentin se Res Publica ishte “debitor” dhe se duhej të shlyente detyrimet financiare për të marrë shërbime të tjera. Vetëm pas një ankimi të dytë, Komisioneri ndërhyri sërish duke detyruar dhënien e informacionit.

Ky rast tregon qartë se si tarifat e vendosura në mënyrë arbitrare mund të shndërrohen në një mjet pengues të së drejtës për informim. Përtej dispozitave ligjore që garantojnë akses të lirë ose me kosto minimale, praktika e Bashkisë Tepelenë krijon një barrë financiare të pajustificuar për qytetarët dhe organizatat, duke e shndërruar një detyrim ligjor në një “shërbim” me pagesë. Kjo jo vetëm bie ndesh me frymën e ligjit, por cenon në thelb të drejtën për informim, duke e kushtëzuar atë me mundësinë ekonomike të kërkuesit.

Në këtë kontekst, ndërhyrja e Komisionerit ka qenë e domosdoshme për të rivendosur parimet e ligjit. Por rasti i Tepelenës me qendrën Res Publica nuk është i vetmi. E njëjta praktikë është konstatuar edhe në raste të tjera, ku tarifa e tepruar është përdorur për të kufizuar transparencën. Vendime si ai i Komisionerit nr. 02, datë 09.01.2024, dëshmojnë nevojën për mbikëqyrje të vazhdueshme dhe për forcimin e mekanizmave ndëshkues ndaj institucioneve që përdorin tarifat si mjet bllokues ndaj së drejtës për informim.

VIII. KONKLUZIONE

Dhjetë vjet pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, panorama e përgjithshme e zbatimit të tij mbetet larg pritshmërive të standardeve ligjore dhe ndërkombëtare. Edhe pse legjislacioni shqiptar konsiderohet ndër më progresivët në rajon dhe është përforcuar me amendamentet e vitit 2023 dhe me ratifikimin e Konventës së Tromsos, problemi kryesor vazhdon të mbetet zbatimi praktik.

Gazetarët, aktivistët dhe qytetarët e zakonshëm vijojnë të hasin vonesa, refuzime dhe mospërgjigje, gjë që kufizon efektivitetin e ligjit dhe e bën të drejtën për informim shpesh një proces të pasigurt.

Gjetjet e këtij raporti japin një tablo të detajuar të problematikave, e cila përmbledhet si më poshtë:

8.1 Reagimi ndaj kërkesave për informacion

- Në vitin 2024, nga 200 kërkesa të monitoruara, vetëm 62% u plotësuan plotësisht, 9% pjesërisht, ndërsa 29% mbetën pa përgjigje, ose një e treta e rasteve, edhe pas një dekade.
- Kohëzgjatja e kthimit të përgjigjeve ka qenë mesatarisht 18 ditë kalendarike, pra mbi afatin ligjor, edhe pse pak më mirë se një vit më parë (23 ditë).
- Pas ankimit administrativ, 89% e institucioneve dhanë informacion në 2024, shifra më e lartë e katër viteve të fundit. Megjithatë, ky nivel nuk është i qëndrueshëm ndër vite, duke treguar mungesë konsistence.
- Kohëzgjatja e reagimit pas ankimit mbetet e lartë, mesatarisht 20–25 ditë kalendarike, çka e zbeh efektivitetin e këtij mekanizmi.
- Për raste të ndjeshme (kontrata koncesionare, prokurime, etj.), institucionet shpesh nuk zbatojnë vendimet e Komisionerit dhe madje as ato gjyqësore.

8.2 Programet e transparencës

- 65% e institucioneve të monitoruara në 2024 kanë një përmbushje “të kënaqshme” të programeve të transparencës, një rritje e ndjeshme krahasuar me 18% në vitin 2015.
- Vetëm 1 autoritet publik (Komisioneri për të Drejtën e Informimit) ka përmbushur plotësisht programin me 100 pikë.
- 10% e institucioneve nuk kanë ende program transparence, ndërsa shumë të tjera publikojnë vetëm të dhëna minimale.
- Autoritetet e varësisë dhe ato të drejtësisë shënuan përmirësimin më të madh, ndërsa pushteti vendor shfaq regres.
- Informacionet më shpesh të publikuara janë të natyrës formale (adresat, oraret, kontaktet), ndërsa më pak publikohen të dhëna mbi buxhetin, kontratat e prokurimit, zbatimin e kontratave dhe raportet e performancës.

8.3 Struktura për zbatimin e ligjit

- Në vitin 2024, 17% e institucioneve nuk kanë koordinator ose nuk e kanë publikuar se kush është koordinatori, ndërsa 15% kanë koordinatorë vetëm formalisht, pa të dhëna kontakti.
- Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve mbetet problematik. Edhe pse mungesa është ulur nga 90% në vitet e para në 18% në 2024, shumica e regjistrave janë bosh ose jo funksionalë.
- Vetëm 3% e institucioneve zbatojnë standardin e ri të vendosjes së datës së përditësimit të dokumenteve, siç kërkohet nga amendamenti i vitit 2023.
- Këto tregues dëshmojnë se elementët bazë të transparencës proaktive ende nuk janë shndërruar në një kulturë pune të administratës.

8.4 Veprimtaria e Komisionerit

- Numri i ankesave ka mbetur i lartë (939 në vitin 2024), në nivele të ngjashme me 2021–2023, duke reflektuar rezistencën e vazhdueshme të institucioneve.
- Në 2024, Komisioneri mori vetëm 22 vendime, më pak se 3% e ankesave, niveli më i ulët i pesë viteve të fundit.
- Nga këto vendime 64% ishin pranuese, 4% të pjesshme dhe 32% rrëzime, shifra më e lartë e refuzimeve në dekadë.
- Vetëm 36% e vendimeve u morën brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, edhe pse më mirë se 2023 (4%).
- U vendosën vetëm 4 gjoba në 2024, kryesisht për mospërditësim të programeve të transparencës. Ky numër mbetet i papërfillshëm krahasuar me shkeljet masive.
- Komisioneri vijon të shfaqë dobësi të mëdha në vendimmarrje, respektimin e afateve dhe përdorimin sistematik të sanksioneve.

8.5 Çështje të veçanta dhe institucione të tjera

- Agjencia për Media dhe Informim (AMI) ka rezultuar joefektive. Në tre vite ka trajtuar vetëm 159 kërkesa dhe shpesh perceptohet si një filtër burokratik që e vonon ose selekton informacionin.
- Ligji për të dhënat e hapura (nr. 33/2022) mbetet i pazbatuar. Vetëm 18% e institucioneve kanë rubrikë “open data”, por shumica janë bosh. Praktikisht funksionon në vetëm 8%.

- Publeaks.al ka dëshmuar rëndësi të veçantë si instrument praktik. Mbi 2 500 kërkesa të trajtuara në 10 vite, përdorues kryesisht me arsim të lartë (Master/Bachelor) dhe grupmoshën 20–40 vjeç, me një balancë gjinore pothuaj të barabartë.

8.6 Zhvillime ndërkombëtare

- Ratifikimi i Konventës së Tromsos (2022) është një hap madhor që vendos Shqipërinë në linjë me standardet evropiane, por zbatimi praktik mbetet i dobët.
- Raporti bazë i Access Info Group (AIG) në 2025 konfirmoi përputhjen ligjore, por theksoi abuzimin me kufizimet (sekret profesional) dhe mungesën e transparencës proaktive.

Ligji për të drejtën e informimit në Shqipëri është një kornizë ligjore progresive, e pasuruar me amendamente të reja dhe të mbështetur nga instrumente ndërkombëtare. Por, problemi thelbësor mbetet hendeku mes ligjit dhe zbatimit.

- Transparenca proaktive është rritur në shifra, por jo në cilësi.
- Transparenca reaktive mbetet e kufizuar nga vonesat dhe mospërgjigjet.
- Komisioneri nuk garanton ekzekutimin efektiv të së drejtës.
- Agjencia për Media dhe Informim nuk ka justifikuar ekzistencën e saj.
- Ligji për të dhënat e hapura ka mbetur në letër.
- Roli i shoqërisë civile, gazetarëve dhe platformave si Publeaks.al është vendimtar për ta mbajtur gjallë këtë të drejtë.

IX. REKOMANDIME

Nisur nga konkluzionet e mësipërme dhe në vijim të monitorimeve të vazhdueshme ndër vite, rekomandojmë sa vijon:

Rekomandimi nr. 1

Kuvendi të përfshijë raportet e shoqërisë civile në vlerësimin e Komisionerit

Përpara miratimit të Rezolutës vjetore për vlerësimin e punës së Komisionerit, Kuvendi i Shqipërisë duhet të marrë në konsideratë raportet dhe gjetjet e organizatave të shoqërisë civile dhe të medias. Vetëm kështu vlerësimi do të pasqyrojë realisht problematikat me të cilat përballen qytetarët dhe gazetarët në ushtrimin e të drejtës për informim.

Rekomandimi nr. 2

Komisioneri të marrë vendim për çdo ankesë

Çdo ankesë e depozituar pranë Komisionerit duhet të përmbillet me vendim të shkruar dhe të publikuar, si forma e vetme që njeh ligji. Shkresat informale ose komunikimet jozyrtare krijojnë pasiguri dhe dëmtojnë garantimin e të drejtës.

Rekomandimi nr. 3

Rritja e përdorimit të sanksioneve

Në kushtet kur shkeljet e ligjit janë të shpeshta dhe të përsëritura, zbatimi i sanksioneve administrative duhet të jetë më sistematik. Vendosja e gjobave të rregullta, sidomos për rastet flagrante të mospërgjigjes, vonesave apo refuzimeve arbitrare, është mënyra më e efektshme për të rritur respektimin e ligjit.

Rekomandimi nr. 4

Rishikimi i udhëzimeve për anonimizimin e vendimeve gjyqësore

Politika aktuale e anonimizimit të vendimeve gjyqësore e trajton publikimin si përjashtim dhe fshehjen si rregull. Kjo duhet të ndryshojë. Publikimi duhet të jetë rregull dhe anonimizimi vetëm në raste të veçanta, duke respektuar standardet kushtetuese dhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rekomandimi nr. 5

Vendimet gjyqësore për kërkime informacioni të jenë të formës së prerë me një shkallë gjykimi

Për të shmangur zvarritjet shumëvjeçare, gjykimet për çështje të të drejtës për informim duhet të përfundojnë me vendim përfundimtar që në një shkallë gjykimi (për shembull në shkallë të parë ose të shqyrtohen direkt në Apel, njësoj si praktika në fushën e prokurimeve publike). Kjo përputhet edhe me standardin e Konventës së Tromsø për dhënie të shpejtë të informacionit.

Rekomandimi nr. 6

Rishikimi i kostos së riprodhimit të dokumenteve

Duhet të sigurohet që çdo tarifë për dokumentet të kufizohet vetëm në koston reale të riprodhimit dhe jo të kthehet në pengesë. Dokumentet elektronike, edhe voluminoze, duhet të ofrohen falas përmes e-mail-it apo sistemeve online.

Rekomandimi nr. 7

Shfrytëzimi i “gjyqtarëve të medias”

Gjykatat duhet të promovojnë përdorimin e “gjyqtarëve të medias”, të cilët mund të japin vendime të shpejta e efektive për aksesin në informacion gjyqësor. Ky mekanizëm është ende i pazhvilluar, megjithëse ekziston prej reformës në drejtësi.

Rekomandimi nr. 8

Rishikimi i rolit të Agjencisë për Media dhe Informim (AMI)

AMI nuk ka justifikuar deri më tani funksionin e saj si garant transparence. Rekomandohet rishikimi i funksioneve ose integrimi i saj në struktura ekzistuese, për të shmangur shtimin e burokracisë dhe filtrimin e panevojshëm të informacionit.

Rekomandimi nr. 9

Zbatimi real i ligjit për të dhënat e hapura

Vetëm 8% e institucioneve kanë implementuar realisht rubrikën “open data”. Duhet të vendosen afate konkrete, detyrime për publikim mujor dhe sanksione për rubrika boshe.

Portali opendata.gov.al të konsolidohet si burim unik i të dhënave zyrtare.

Rekomandimi nr. 10

Fuqizimi i koordinatorëve për të drejtën e informimit

Duhet ngritur një regjistër publik i koordinatorëve, i përditësuar në kohë reale nga Komisioneri. Koordinatorët të trajnohen dhe certifikohen rregullisht dhe mosfunksionimi i tyre të sanksionohet edhe në nivel disiplinor për titullarët.

Rekomandimi nr. 11

Forcimi i rolit të Publeaks.al dhe shoqërisë civile

Platforma Publeaks.al është dëshmuar si një instrument efektiv. Duhet të mbështetet financiarisht dhe të promovohet për përdorim masiv nga qytetarët, jo vetëm nga gazetarët e aktivistët.



RESPUBLICA

Adresa: Bul. "Gjergj Fishta",
Nd. 24, H. 3, Ap. 7, Tiranë

Tel.: +355 69 940 8875

E-mail: qendra.respublica@gmail.com

Web: www.respublica.org.al
www.publeaks.al

